



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

dldp
decentralisation and local
development programme



HELVETAS
Swiss Interooperation

ALBANIA

PLANIFIKIMI FINANCIAR AFATMESËM PËR QEVERITE VENDORE NE KONTEKSTIN E SHQIPËRISË

MANUAL PËR INSTRUMENTIN E PLANIFIKIMIT FINANCIAR ME BAZË EXCEL, VERSION I DYTË

2

SHTATOR 2017

**PLANIFIKIMI FINANCIAR AFATMESËM PËR
QEVERITË VENDORE
NË KONTEKSTIN E SHQIPËRISË**
MANUAL PËR INSTRUMENTIN E PLANIFIKIMIT FINANCIAR
ME BAZË EXCEL, VERSION I DYTË

21 Shtator 2017
Stefan PFÄFFLI, Alex LÖTSCHER, Sabina YMERI

**Ky publikim është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp),
me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim**

Përgatitur nga:

Sabina Ymeri - Istituti Studimeve Bashkohore
Prof. Stefan Pfaeffli & Alex Loetscher
University of Applied Sciences and Arts, Lucerne Business School, Switzerland

Mbështetur nga:

Valbona Karakaçi, Elvin Hoxha
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)
HELVETAS Swiss Intercooperation, Shkodër, Albania

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC.

Publikuar nga:

**Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)
HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI) Albania
Copyright © HSI Albania**

Adresa:

Rr. Oso Kuka, Nr. 11,
4000 Shkodër, Albania

www.dldp.al

TABELA E LËNDËS

1.	HYRJE.....	6
2.	KUADRI I PËRGJITHSHËM DHE STRUKTURA E INSTRUMENTIT.....	8
3.	SKEDAT INPUT	11
3.1.	Titulli (A1)	11
3.2.	Informacion i Përgjithshëm (B1).....	11
3.3.	Organizata (B2)	11
3.4.	Struktura Funksionale (B3).....	13
3.5.	Shpenzimet e Vitit të Kaluar (C1)	14
3.6.	Investimet e Vitit të Kaluar (C1b)	15
3.7.	Burimet e Vitit të Kaluar (C2)	15
3.8.	Të Prapambetura (C3)	16
3.9.	Të Mbartura me Destinacion (C4)	17
3.10.	Angazhimet (C5).....	17
3.11.	Tavanet (D1).....	18
3.12.	Premisa Makroekonomike (D2).....	19
3.13.	Përlllogaritja e të Ardhurave I: Taksa (E1)	20
3.14.	Përlllogaritja e Burimeve: Taksat e Ndara (E1)	22
3.15.	Përlllogaritja e Burimeve: E1: Tarifat	22
3.16.	Përlllogaritja e Burimeve: Të Ardhura Jo-tatimore (E1).....	23
3.17.	Përlllogaritja e të Ardhurave nga Buxheti i Shtetit (transfertat) dhe Huatë (E1)	23
3.18.	Formularët e Kërkesës Buxhetore FKB (FKB1 - FKB29)	23
4.	TË DHËNAT OUTPUT DHE INTERPRETIMI I TYRE (F1 - F16)	31
5.	LISTA E TERMAVE TEKNIKË DHE SHKURTIMEVE	33
6.	ANEKS: PËRSHKRIM I PROGRAMEVE DHE AKTIVITETEVE.....	35
	SEKTORI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE.....	35
	011: Organet Ekzekutive dhe Legjislative, Çështjet Financiare dhe Fiskale, Çështjet e Jashtme.....	35
	013: Shërbime të Përgjithshme Publike.....	36
	SEKTORI 3: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE.....	37
	031: Shërbimet Policore.....	37
	032: Shërbimet e Mbrojtjes nga Zjarri.....	37
	036: Masa të Tjera për Rendin dhe Sigurinë Publike	37
	SEKTORI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE	38
	041: Çështje të Përgjithshme Ekonomike, Tregtare dhe të Punës	38
	042: Bujqësia, Pyjet, Peshkimi dhe Gjuetia.....	38
	045: Transporti.....	39
	047: Industri të Tjera.....	39
	SEKTORI 5: MBROJTJA E MJEDISIT	41
	051: Menaxhimi i Mbetjeve.....	41
	052: Menaxhimi i Ujërave të Zeza	41
	053: Zvogëlimi i Ndotjes.....	41
	056: Mbrojtja Mjedisore, t.sh.a.....	41
	SEKTORI 6: STRUKTURAT E STREHIMIT DHE KOMUNITETIT	43
	061: Urbanistika	43
	062: Zhvillimi i Komunitetit	43
	063: Furnizimi me Ujë	44
	064: Ndriçimi i Rrugëve	44
	SEKTORI 7: SHËNDETËSIA	45
	072: Shërbimet e Kujdesit Parësor	45
	SEKTORI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA.....	45

081: Shërbime Çlodhëse dhe Sportive.....	45
082: Shërbime Kulturore	45
SEKTORI 9: ARSIMI	46
091: Arsimi bazë dhe Parashkollor	46
092: Arsimi i Mesëm.....	46
096: Shërbimet Ndhmëse për Arsimin.....	46
SEKTORI 10: KUJDESI SHOQËROR	47
101: Sëmundje dhe Paaftësi	47
102: Pleqëria	47
104: Familja dhe Fëmijët	48
105: Papunësia	49
106: Strehimi.....	49
107: Kujdesi Social.....	50

FIGURA

Figura 1: Skeda me Ngjyra që Përfaqësojnë Klasa të Ndryshme Fletësh.....	8
Figura 2: B2 - Organizimi	12
Figura 3: B3- Struktura Funktionale	14
Figure 4: C1 – Shpenzimet e Vitit të Kaluar	15
Figure 5: C2 - Burimet Buxhetore të Vitit të Kaluar	16
Figura 6: D1 - Tavanet	19
Figura 7: D2 - Premisa Makroekonomike.....	20
Figura 8: E1 - Taksat	21
Figura 9: E1- Tarifat	23
Figura 10: E4 – Të Tjera	23
Figura 11: FKB1 deri FKB29 – Formulari i Kërkesës Buxhetore	26
Figura 12: Përlllogaritja e Shpenzimeve për Aktivitet/Projekt	27
Figura 13: Përlllogaritja e të Ardhurave brenda Formularit të Kërkesës Buxhetore	29

TABELA

Tabela 1: Klasat e Fletëve të Punës dhe Karakteri i Tyre	8
Table 3: Tregues Financiarë.....	32

1. HYRJE

Prej vitit 2009, qeveritë vendore shqiptare janë të detyruara të përgatisin një buxhet afatmesëm të bazuar në ligjin 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Me buxhetin afatmesëm ligji kërkon një qasje dhe plan financiar të integruar për një kuadër kohor trevjeçar. Ligji 68/2017 për financat vendore konfirmoi dhe specifikoi më tej këtë kërkesë ligjore. Buxheti afatmesëm është një hallkë ndërmjet planifikimit afatgjatë strategjik në një kuadër kohor dhjetëvjeçar ose më shumë; si dhe buxhetit vjetor.

Tradicionalisht, buxhetet e enteve publike kanë një shtrirje vetëm njëvjeçare. Mangësia e buxheteve njëvjeçare është orientimi i tyre afatshkurtër. Zakonisht, në një afat të shkurtër, ka pak fleksibilitet buxhetor për të shpërndarë burimet e pakta në një vijë me përparësitë e zhvillimit strategjik. Për të pasur më shumë largpamësi buxhetore, është futur orientimi i buxhetit afatmesëm si një plotësim i buxhetit vjetor. Ka qenë një ide e mirë që të fillonte zgjerimi i horizontit të planifikimit buxhetor edhe në qeverisjet vendore shqiptare që më 2009; por qeveritë vendore shqiptare në atë kohë nuk ishin në gjendje të përgatisnin buxhete afatmesme në mënyrë të përshtatshme.

Planifikimi financiar për afate të shkurtra dhe të mesme u identifikua si një sfidë kryesore për qeverisjen vendore shqiptare. Për këtë arsye, që më 2010, projekti i decentralizimit dhe zhvillimit vendor, dldp, i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation SDC dhe i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation, përpunoi idenë e lehtësimit të procesit të buxhetit afatmesëm nëpërmjet një instrumenti elektronik të planifikimit financiar (IPF). Instrumenti duhej të ishte me kosto të ulët, i përshtatshëm për kontekstin shqiptar dhe i zbatueshëm në çdo bashki të Shqipërisë. Veç këtyre, ai duhej të formulohej në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare për hartimin e buxhetit dhe të respektonte kërkesat ligjore shqiptare për hartimin e buxhetit. Mbështetësi i dldp në Universitetin e Shkencave të Aplikuara dhe Arteve të Lucernës - HSLU – e promovoi me forcë këtë ide; ekspertët e HSLU dhanë mbështetje teknike dhe konceptuale në bashkëpunim me ekspertët lokalë të dldp-së, ndërsa specialistët e Ministrisë së Financës siguruan përputhjen e saj në kontekstin shqiptar.

Dalja e parë e IPF u testua në terren nga ekspertët vendorë të dldp në vjeshtë 2011 dhe pranverë 2012 në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Ministrisë së Financave dhe u përkthye në shqip. IPF u përfshi në paketën e plotë të PZHSepBA të dldp, ku PZHS do të thotë planifikimi i zhvillimit strategjik, PBA – programi i buxhetit afatmesëm dhe e IPF elektronike.

Në verë 2012, IPF ishte gati për përdorim; ai iu shpërnda të gjitha bashkive shqiptare nga Ministria e Financave. Dldp siguron trajnim dhe praktikë në terren për qeveri të përzgjedhura vendore; instrumenti është përdorur për planifikimin financiar afatmesëm në një numër gjithnjë e më të madh bashkish shqiptare, edhe në bashki që nuk ishin mbështetur nga dldp.

Në qershor 2017, kur ligji për vetëqeverisjen financiare vendore u miratua, u bë i detyrueshëm një përditësim i IPF. Ekspertë të IPF të dldp dhe ekspertë nga Ministria e Financave identifikuan nevojat e ndryshme për korrigjim në bashkëpunim të ngushtë me mbështetësin e HSLU. Me daljen e dytë, u fut një klasifikim i ri i të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përfshirë një strukturë të re dhe uniforme programi. Gjithashtu kodet e klasifikimit u vunë në një linjë me Thesarin Kombëtar. Sistemi i ri i klasifikimit është bazuar në standardet ndërkombëtare; ai bën të mundur krahasimet gjatë kohës dhe horizontalisht me bashkitë e tjera; veç kësaj, ai lehtëson integrimin e informacionit për planifikimin financiar bashkiak në Thesarin Kombëtar. Për më tepër, të gjitha zërat e shpenzimeve të sistemit të klasifikimit janë të përshkruar saktësisht dhe është e mundur të lidhen rezultati i IPF me PBA.

Dalja e dytë e IPF u bë gati për përdorim në shtator 2017.



Qëllimi i manualit të IPF është t'u japë përdoruesve (qeverive vendore dhe subjekteve të tjera ekonomike të interesuara) një ndihmë të gjithanshme në përdorimin e IPF për përgatitjen e planeve buxhetore vjetore dhe afatmesme. Është synuar që manuali të botohet si një dokument dinamik që do të përditësohet rregullisht, duke iu përgjigjur çështjeve, shqetësimeve dhe pyetjeve të tjera të shpeshta të bëra nga zyrtarët shtetërorë dhe subjekte të tjera ekonomike.

2. KUADRI I PËRGJITHSHËM DHE STRUKTURA E INSTRUMENTIT

Në kufijtë e fletëve do të gjeni skeda që ju lejojnë të hidheni nga njëra fletë te tjetra. Këto skeda janë me ngjyra të ndryshme. Secila ngjyrë përfaqëson një klasë të ndryshme fletësh, si tregohet në Figura 1.

Figura 1: Skeda me Ngjyra që Përfaqësojnë Klasa të Ndryshme Fletësh

Head of department of finance	Elvin
Street	Street
Post code	22222
City	Dures
Date of actualisation (year, month, day)	10 June 2017
Population (census data, end of the last year)	175,000
Number of staff (end of last year)	750
Number of full time staff (end of last year)	500
Number of part time staff (end of last year)	250
All figures are in	LEK



Në Tabelën 1 janë paraqitur klasa të ndryshme fletësh. Një dallim mund të bëhet midis fletëve input (me hyrje të dhënash) dhe output (me dalje të dhënash). Fletët në hyrje duhet të mbushen në mënyrë manuale. Fletët në dalje prodhohen automatikisht nga IPF. Për fletët e hyrjes duhet përcaktuar qartë përgjegjësia e krijimit të informacionit dhe e futjes së tij në formular. Përgjegjësitë e treguara në Tabela 1 mund të përdoren si një zgjidhje standarde për përpunimin e formularëve.

Tabela 1: Klasat e Fletëve të Punës dhe Karakteri i Tyre

<i>Kodi</i>	<i>Ngjyra skedës</i>	<i>e Përmbajtja e fletës</i>	<i>Karakteri i fletës</i>	<i>Përgjegjësia për futjen e të dhënave</i>
A1	e gjelbër	Kopertina	output/vetëm lexim	-
B1-B3	kaltër e lehtë	Buxheti-Struktura dhe organizimi	Input/hyrje	Departamenti i Buxhetit
C1-C5	portokalli	Shifrat e vitit të kaluar: Shpenzimet; Fondet për investime Të ardhurat; të mbartura; Angazhime Të prapambetura	input	Departamenti i Financës

D1&D2	vishnje e lehtë	Udhëzime buxhetore (tavanet dhe premisat makroekonomike)	input	Departamenti i Financës
E1	portokalli	Përlllogaritja e burimeve	input	Departamenti i Financës
BRF1-BRF29	e kuqe	Formularët e kërkesës buxhetore: Llogaritja e shpenzimeve të programit	input	Departamentet e linjës
F1 & F2	e gjelbër	Kuadri i burimeve buxhetore dhe shpenzimeve bruto (tabela)	output	-
F3	e gjelbër e lehtë	Kuadri i shpenzimeve bruto për çdo funksion (grafik)	output	-
F4	e gjelbër	Kuadri i shpenzimeve neto për çdo program (tabelë)	output	-
F5	e gjelbër e lehtë	Kuadri i shpenzimeve neto për çdo program (grafik)	output	-
F6	e gjelbër	Kuadri i shpenzimeve bruto për çdo sektor (tabelë)	output	-
F7	e gjelbër e lehtë	Kuadri i shpenzimeve bruto për çdo sektor (grafik)	output	-
F8	e gjelbër	Kuadri i shpenzimeve sipas llojit të aktivitetit (tabelë)	output	-
F9	e gjelbër e lehtë	Kuadri i shpenzimeve sipas llojit të aktivitetit (grafik)	output	-
F10	e gjelbër e lehtë	Kuadri i shpenzimeve bruto sipas klasifikimit ekonomik (tabelë)	output	-
F11	e gjelbër e lehtë	Kuadri i shpenzimeve bruto	output	-

		sipas klasifikimit ekonomik (tabelë)		
F12	e gjelbër e lehtë	Të prapambetura në fund të vitit	output	-
F13	e gjelbër	Statistika financiare tërësore	output	-
F14	e gjelbër	Tregues fiskalës	output	-
F15	e gjelbër e lehtë	Investime kapitale - grafik	output	-
G1 – G3	e verdhë e errët	Përkthyes		Përkthyes

3. SKEDAT INPUT

Për secilin prej llojeve të ndryshme të skedave input më poshtë pason një instruksion i detajuar. Manuali shpjegon motivin e çdo skede; veç kësaj, ai jep udhëzim si mund të mbushet ajo. Vetëm në hapësirat e nënvizuara me të verdhë ose, sipas rastit, me gjyrë ulliri, ka nevojë të futet informacion.

Informacion i përgjithshëm:

3.1. Titulli (A1)

Formulari “Titulli A1” prodhohet automatikisht. Ai përmban informacion për shtrirjen kohore të planit buxhetor, si dhe informacion njohës për administratën bashkiake, që ka migruar nga fletët pasardhëse. Nuk kërkohen të dhëna për hyrje.

3.2. Informacion i Përgjithshëm (B1)

Për t’u plotësuar nga: Departamenti i Buxhetit

Formulari “B1 Informacion i përgjithshëm” përkufizon periudhën e planifikimit. Ky informacion përdoret për të përshtatur të gjithë formularët e seksionit C seksionit F dhe me titullin e faqes. Pjesa e poshtme e formularit përdoret për të plotësuar titullin e faqes.

Formulari B2 mbushet nga Departamenti i Financës. Plotëso në kutitë e verdha të mëposhtme:

1. Viti në vazhdim: Lutemi, fusni vitin financiar në vazhdim; d.m.th. 2017, kur po përgatisni planin e buxhetit 2018–2020. Programi do të paraqesë automatikisht vitet e periudhës buxhetore që duhet planifikuar.
2. Blloku i dytë kërkon informacion të përgjithshëm për bashkinë, që përdoret për të plotësuar titullin e faqes (A1). Në veçanti, informacioni që duhet formuluar në këtë bllok kërkon edhe numrin e popullsisë dhe numrin e stafit që punon për administratën (mes tij stafin e përhershëm)
3. Në bllokun e tretë, duhet të zgjidhni midis futjes së të dhënave në lekë ose, në mënyrë alternative, në mijë/njëqind mijë ose million lekë or milion Lek. Shtyp shigjetën në të djathtë të kutisë dhe zgjidh një prej opsioneve nga menuja kaskadë (Lek; 1000 Lekë; 100,000 Lekë; 1,000,000 Lekë). Lutemi, mbani mend zgjedhjen që keni bërë, për të ruajtur vazhdimësinë gjatë programit

3.3. Organizata (B2)

Fleta “B2-Organizata” përcakton strukturën e buxhetit dhe të programeve të buxhetit që ajo përmban. Emrat e programeve janë të paracaktuara në linjë me klasifikimin buxhetor shqiptar, siç është miratuar nga Ministria e Financave. Lista përfshin gjithsej 29 programe. Jo të gjitha programet do të përdoren për çdo qeveri vendore në çdo vit buxhetor. Mbi emrat e programeve nuk mund të shkruhet. Departamenti i Financës is është i ngarkuar të plotësojë këtë fletë pune.

Klasifikimi buxhetor është bazuar në klasifikimin e sektorëve¹ të bazuar në standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të klasifikimit, si më poshtë:

¹COFOG – Classification of the Functions of Government, <https://unstats.un.org/unsd/cr/registry/regcst.asp?Cl=4>

- 01 – Shërbimet e përgjithshme publike
- 02 - Mbrojtja
- 03 – Rendi dhe siguria publike
- 04 – Çështjet ekonomike
- 05 – Mbrojtja e mjedisit
- 06 – Strehimi dhe komoditetet e komunitetit
- 07 - Shëndeti
- 08 – Çlodhje, kulturë dhe fe
- 09 - Arsimi
- 10 – Mbrojtja shoqërore

Një apo më shumë prej fushave të programuara/programeve të buxhetit janë klasifikuar brenda secilit sektor kryesor. Çdo program është identifikuar me emrin e tij, si dhe me një kod të klasifikimit buxhetor treshifror. Kodet janë uniforme në të gjithë sistemin buxhetor dhe formojnë bazën e ekzekutimit të buxhetit nëpërmjet thesarit. Një përshkrim i përmbajtjes së politikës të çdo programi mund të gjendet në orientimin e PBA 2017 dhe në shtojcën e këtij dokumenti.

Synimi qendror i formularit B2 është lidhja e sektorëve me programet dhe dhënia e një kuadri të përgjithshëm të strukturës programatike të buxhetit.

Për të plotësuar formularin B2, përcaktoni njësinë administrative përgjegjëse për çdo program; emrin e kreut të programit/njesisë në administratën bashkiake dhe numrin e punonjësve që janë të angazhuar me programin (d.mth. punonjësit në njësi që janë drejtpërdrejt përgjegjës për programin). Ky informacion do të përdoret për Formularët e Kërkesës Buxhetore.

Informacioni i futur në këtë fletë përdoret për të përshtatur një seri formularësh input dhe output. Hyrjet e pasakta ose të paplota në këtë fazë nuk mund të korrigjohen në formularët pasues. Nuk është e mundur të mbishkruhet në hapësirat e nënvizuara me ngjyrë të kaltër safiri ose të hijëzuara me ngjyrë hiri.

Figura 2: B2 - Organizimi

Yellow = to fill in by department of finance

(B2) ORGANISATION STRUCTURE				
Number	Name of program	Directorate / Department	Head of program	Number of employees
Program 1	011 Executive and legislative organs, financial, fiscal, external affairs	Educational unit	Fran	4
Program 2	013 General services	BB	BBB	5
Program 3	031 Police services	CC	CCC	6
Program 4	032 Fire-protection services	DD	DDD	
Program 5	036 Further public order and safety measures	EE	EEE	
Program 6	041 General economic, commercial and labour affairs	FF	FFF	
Program 7	042 Agriculture, forestry, fishing and hunting	GG	GGG	
Program 8	045 Transport	HH	HHH	
Program 9	047 Other industries	II	III	5
Program 10	051 Waste management	JJ	JJJ	
Program 11	052 Waste water management	KK	KKK	5
Program 12	053 Pollution reduction	LL	LLL	
Program 13	056 Environmental protection (n.e.c)	MM	MMM	
Program 14	061 Housing development	NN	NNN	5
Program 15	062 Community development	OO	OOO	
Program 16	063 Water supply	PP	PPP	
Program 17	064 Street lighting	QQ	QQQ	
Program 18	072 Outpatient services			1
Program 19	081 Recreational and sporting services			5
Program 20	082 Cultural services	TT	TTT	
Program 21	091 Basic and preschool education	UU	UUU	5
Program 22	092 Secondary education	VV	VVV	
Program 23	096 Subsidiary services to education	VV	VVV	5
Program 24	101 Sickness and disability	VV	VVV	
Program 25	102 Old age	VV	VVV	
Program 26	104 Family and children	VV	VVV	
Program 27	105 Unemployment	VV	VVV	
Program 28	106 Housing	VV	VVV	
Program 29	107 Social assistance	VV	VVV	
				15

Navigation: (A1) Title (B1) General Information (B2) Organisation (B3) Functional structure (C1) Last years expenditure

3.4. Struktura Funktionale (B3)

Plotësohet nga: Departamenti i Buxhetit

Formulari “B3 – Struktura funksionale” përdoret për të identifikuar aktivitetet e çdo programi. Termi “aktivitet” përdoret këtu për detyra të detajuara në vazhdim të qeverisë vendore; ky është niveli më i ulët i përdorur për klasifikimin funksional-programatik. Aktivitetet kanë një kod 5-shifror që përfshin kodin e programit dhe të sektorit.

Një përshkrim i saktë i përmbajtjes së politikës që i përket çdo aktiviteti mund të gjendet në udhëzimin e PBA 2017 dhe shtojcën e këtij manuali.

IPF bën një dallim midis aktiviteteve të bazuar në natyrën e tyre, nëse ato janë të lidhura me një autoritet të vet qeverisë lokale, janë të deleguara ose janë transferuar rishtas (menuja kaskadë në Kolonën E)

Rrjedhimisht, edhe programi bën një dallim midis aktiviteteve që janë “të detyrueshme” të kryhen dhe atyre që përfaqësojnë veprime shtesë mbi kërkesat ligjore (menuja kaskadë në Kolonën D).

Aktivitetet e çdo programi janë përcaktuar në IPF (automatikisht). Megjithatë në çdo program ka të paktën një rresht të zbrazët për të shtuar aktivitete të reja të programit që nuk janë përcaktuar. Megjithatë, mos fusni projekte këtu. Projektet kanë një fillim dhe një fund, ndërkohë që aktivitetet janë në vazhdim. Projektet duhet të përfshihen në aktivitetet përkatëse.

Departamenti i Buxhetit duhet të ndjekë këto hapa:

- Në secilin program, kontrolloni nëse janë përmendur aktivitetet kryesore. Aktivitetet e paracaktuara janë shënuar automatikisht nga IPF si “të detyrueshme” dhe është caktuar tipi përkatës i autoritetit (d.m.th. nëse është e vet, e deleguar ose e transferuar rishtas)
- Shto/emërto aktivitetet shtesë, kur është e nevojshme. Shëno nëse ky aktivitet është “i detyrueshëm” (Kolona D); dhe nëse ai është “i vet”, “i deleguar”, ose “i transferuar rishtas” (Kolona E).

Sugjerim: Në formularët e kërkesë buxhetore ka vend për maksimumi katër aktiviteti për çdo fushë të programit. Nëse kjo nuk është e mjaftueshme, shihni mundësinë e bashkimit të aktiviteteve të programit, për të kufizuar numrin e tyre deri në tre ose katër për program, kur kjo është e mundur. Veç kësaj, planifikimi në nivele më agregate ul mundësinë e gabimit.

Informacioni i B3 përdoret për të përshtatur një seri formularësh input dhe output. Hyrjet e pasakta ose të paplota në këtë fazë nuk mund të korrigjohen në formularët pasues. Nuk është e mundur të mbishkruhet në hapësirata e panëvizuara me të verdhë.

Figura 3 poshtë jep një ekstrakt të fletës B3.² Përzgjidhni nga menuja kaskadë në dy kolonat e fundit, për të përcaktuar natyrën e aktiviteteve: nëse këto aktivitete janë të detyrueshme apo shtesë dhe nëse janë të lidhura me funksionet e veta, të deleguara apo të transferuara rishtas.

² IPF nuk ofron hapësirë për përshkrim të qartë të aktiviteteve. Rekomandohet që ky informacion të bëhet i disponueshëm si pjesë e përshkrimit të programit në PBA.

Figura 3: B3- Struktura Funktionale

ellow # to fill in by department of finance

(B3) ACTIVITIES PER PROGRAM AND PER FUNCTION				
		Name of Activity	Activity: obligatory / additional	Activity: own / delagated / specially transferred
01 General public services				
Program 1	011	Executive and legislative organs, financial and fiscal		
Activity 1a	01111	Planning, management and administration	obligatory	own
Activity 1b	01121	Financial and fiscal affairs	obligatory	own
Activity 1c	01122	Amortisation of arrears	obligatory	own
Activity 1d	01131	General public services	obligatory	own
Activity 1e	1199	ABC	additional	own
Program 2	013	General services		
Activity 2a	01311	Territorial planning	obligatory	own
Activity 2b	01321	Cemeteries and funerals	obligatory	own
Activity 2c	01711	Payment for Domestic debt service	obligatory	own
Activity 2d				
03 Public order and safety				
Program 3	031	Police services		
Activity 3a	03141	Municipality police services	obligatory	own
Activity 3b				
Activity 3c				
Program 4	032	Fire-protection services		
Activity 4a	03281	Fire-fighting and civil protection	obligatory	specially transferred
Activity 4b				
Activity 4c				
Program 5	036	Further public order and safety measures		
Activity 5a	03601	Community relations	obligatory	own
Activity 5b	03602	Local administrative supervision	obligatory	own
Activity 5c		ABC	additional	delegated
04 Economic affairs				
Program 6	041	General economic, commercial and labour affairs		
Activity 6a	04111	Economic development plans	obligatory	own

(A1) Title (B1) General Information (B2) Organisation (B3) Functional structure (C1) Last years expenditures

3.5. Shpenzimet e Vitit të Kaluar (C1)

Për t'u plotësuar nga: Departamenti i Financës.

Në formularin "C1 – Shpenzimet e vitit të kaluar", shpenzimet dhe të ardhurat specifike të lidhura me aktivitetin (duke përfshirë projektet) janë formuluar në kuadrin e dy viteve të fundit dhe të vitit në vazhdim. Formulari ndjek klasifikimin programor siç është paracaktuar në B2 dhe B3. Merrni informacion për dy vitet e fundit nga raporti financiar vjetor. Për vitin në vazhdim fusni të dhëna për **rezultatit e pritshëm buxhetor të fundvitit**.

IPF e kopjon automatikisht informacionin në format e kërkesës buxhetore.

Së pari, formulari C1 kërkon informacion për shpenzimet bruto (totale) për çdo aktivitet për dy vjetët e fundit dhe për vitin në vazhdim (i pritshëm); së dyti, kërkohet informacion për të ardhurat e mbartura dhe tarifin. Informacioni për të ardhurat nga tarifin dhe të mbartura kërkohet sepse IPF do t'i paraqesë shpenzimet për bruto dhe neto për çdo veprimtari në formular të e kërkesës buxhetore. Shembulli i mëposhtëm shpjegon logjikën e kësaj ideje. Të supozojmë që një NjQV e përmirëson sistemin e saj të grumbullimit të mbetjeve, duke futur sistemin e mbledhjes së diferencuar. Shpenzimi bruto është 1,000,000 lekë. Tarifin: 500,000 lekë, kontributi nga një donator: 200,000 lekë. Kjo do të thotë që shpenzimi neto është vetëm 300,000 lekë. Pse është i rëndësishëm ky informacion? Ndoshta këshilli dëshiron të vlerësojë kostot pa mbledhjen e diferencuar të mbetjeve. Shpenzimi bruto sigurisht do të jetë më i ulët, por ndoshta donator nuk do të dojë të paguajë kontribut.

Një ekstrakt të këtij formulari e gjeni në Figure 4. Departamenti i Financës mbush vetëm hapësirat e verdha të formularit C1. Më pas, departamentet e linjës do ta përdorin këtë informacion si pikënisje për të planifikuar buxhetet e tyre.

Figure 4: C1 – Shpenzimet e Vitit të Kaluar

(C1) EXPENDITURES: LAST YEARS AND CURRENT YEAR									
		2015				2016			
		Year t-2 (actuals)				Last year (actuals)			
		NET AMOUNT REQUESTED	Expend-tures (incl. investments)	Fees	Ear-marked revenues	NET AMOUNT REQUESTED	Expend-tures (incl. investments)	Fees	Ear-marked revenues
vices									
011	Executive and legislative organs, financial and fiscal affairs, external affairs								
01111	Planning, management and administration	3,000	8,000	2,000	3,000	-7,000	4,000	5,000	6,000
01121	Financial and fiscal affairs	53,000	60,000	3,000	4,000	-8,000	5,000	6,000	7,000
01122	Amortisation of arrears	3,500	7,000	0	3,500	3,000	6,000	0	3,000
01131	General public services	-3,000	8,000	5,000	6,000	-7,000	7,000	5,000	9,000
1,199	ABC	-4,000	9,000	6,000	7,000	-11,000	8,000	9,000	10,000
		52,500	92,000	16,000	23,500	-30,000	30,000	25,000	35,000

3.6. Investimet e Vitit të Kaluar (C1b)

Për t'u plotësuar nga: Departamenti i Financës

Në formularin “C1b – Investimet e vitit të kaluar”, janë paraqitur investimet kapitale për vitin në vazhdim (rezultati i pritshëm i fundvitit) dhe i dy viteve të mëparshme financiare. Ky formular ndjek strukturën e programeve dhe aktiviteteve siç është paraqitur në B1 – B3; dhe të njëjtë si në C1: Shpenzimet e vitit të kaluar. Të dhënat duhet të futen në kutitë e verdha për çdo vit të shqyrtuar.

3.7. Burimet e Vitit të Kaluar (C2)

Për t'u plotësuar nga: Departamenti i Taksave/Të ardhurave
Departamenti i Financës

Në formularin “C2 – Burimet buxhetore të vitit të kaluar”, burimet për vitin në vazhdim (**rezultati i pritshëm i fundvitit**) dhe të dy viteve të mëparshme janë përfshirë në një kuadër. Një ekstrakt të këtij formulari e gjeni Figure 5. Ky formular ndjek klasifikimin konvencional të të ardhurave vendore dhe burimeve të fitimit.

Kategoritë kryesore të burimeve të buxhetit janë paraqitur si më poshtë:

1. Të ardhura nga burimet e veta
 - a. Taksa vendore mbi bizneset e vogla
 - b. Taksë mbi pasuritë e paluajtshme (3 lloje)
 - c. Taksa e hotelit
 - d. Taksa e ndikimit të infrastrukturës
 - e. Taksë table
 - f. Taksë vendore mbi donacionet etj.
 - g. Taksa të përkohshme (3 lloje)
2. Të ardhura nga taksat e ndara (ndarë në 5 kategori)
3. Të ardhura nga tarifatat dhe tarifatat e shërbimeve (pasojnë nëndaarjet si janë përcaktuar në Ligjin e Financave Vendore)

4. Të hyra të tjera, duke përfshirë të ardhurat jotatimore, si të ardhurat nga gjobat, shitjet apo qiradhënia e asetëve, të hyra nga asetet ose aktivitete të tjera ekonomike, transferime dhe donacione etj.
5. Të hyra nga buxheti i shtetit: tranderta të pakushtëzuara ose të kushtëzuara, duke përfshirë ndarjen sipas llojeve
6. Të hyra nga huatë
7. Të mbartura nga vitet e kaluara³

Merrni informacion për vitin e kaluar nga raporti financiar vjetor dhe për vitin në vazhdim nga përlllogaritjet për buxhetin e vitit në vazhdim/rezultati i pritshëm i fundvitit. Ky informacion përdoret si pikënisje për përlllogaritjen e të ardhurave me anë të formularëve E1 deri E5. Informacioni kopjohet automatikisht në këta formularë.

Figure 5: C2 - Burimet Buxhetore të Vitit të Kaluar

(C2) ESTIMATION OF BUDGET RESOURCES				
Revenue Item	Code number	2015	2016	2017
		Year t-2 (actuals)	Last year (actuals)	Current year (expected end of year outturn)
REVENUES FROM OWN SOURCES	A	132 900	159 100	175 300
REVENUES FROM LOCAL TAXES	A.1	10 400	11 500	12 600
Local tax on small business	A.1.1			
Tax on immovable properties	A.1.2	400	500	600
Tax on buildings	A.1.2.1			
Tax on agricultural land	A.1.2.2			
Tax on urban land	A.1.2.3			
Tax on property transactions	A.1.2.4	400	500	600
Local taxes on hotel service	A.1.3			
Tax on infrastructure impact of new buildings	A.1.4			
Tax on tables	A.1.5			
Local Taxes on revenues derived from donations, inheritances, testaments and local lotteries	A.1.6			
Temporary taxes	aaa	10 000	11 000	12 000
Temporary tax 1	bbb			
Temporary tax 2	ccc			
REVENUES FROM SHARED TAXES (GRANTS)	A.2	500	600	700
Tax on sale of real estate / immovable property	A.2.1			
Annual tax on circulation of used vehicles	A.2.2	500	600	700
Tax from mine rent	A.2.3			
Personal income tax	A.2.4			
Other taxes	A.2.5			
REVENUES FROM LOCAL FEES	A.3	22 000	27 000	32 000
Fee on waste management	A.3.1	2 000	3 000	4 000
Fee on cleaning for families	A.3.1.1			
Fee on cleaning for institutions	A.3.1.2			
Fee on cleaning for businesses	A.3.1.3	2 000	3 000	4 000
Fee for waste collection and disposal	A.3.2			
Fee on public lighting	A.3.3	14 000	16 000	18 000
Fee on public lighting for families	A.3.3.1			
Fee on public lighting for institutions	A.3.3.2	14 000	16 000	18 000

3.8. Të Prapambetura (C3)

Për t'u plotësuar nga: Departamenti i Financës

Fleta "C3 –Të prapambetura", bën bilancin e detyrimeve të prapambetura që nuk janë shlyer në afatin e caktuar. Ajo synon të paraqesë një tablo të detyrimeve të vonuara dhe të sigurojë që të hartohet një plan i shlyerjes së të prapambeturave brenda të paktën një periudhe afatmesme.

³Teknikisht, nuk ka të hyra të llogaritura për vitet e kaluara. Ai është tepriçë buxhetore-balanca fillestare.

Departamenti i Finance duhet të specifikojë:

- Emrin e kreditorit dhe programin për të cilin ishte bërë shpenzimi (Kolona A dhe B)
- Data e caktuar për pagesën e detyrimit (Kolona C)
- Stoku i borxhit (d.m.th. sasia e detyrimit të vonuar) më 31 tetor të vitit financiar në vazhdim (Kolona D)
- Plani për shlyerjen e detyrimit të vonuar, nëse me pagesa periodike (kolonat I, F, L, O për vitet t, t+1; t+2 and t+3 përkatësisht)

Kolonat në ngjyrë hiri do të nxjerrin automatikisht stokun e borxhit të prapambetur në fund të çdo periudhe financiare. Të dhënat e future në këtë fletë shërbejnë për qëllim informacioni dhe dokumentacioni. Ato do t'i shtohen automatikisht shifrës së rezervuar output F12.

3.9. Të Mbartura me Destinacion (C4)

Për t'u plotësuar nga: Departamenti i Financës

Fleta C4 përvijon të mbarturat me destinacion (shpenzimet e angazhuara) në përputhje me klasifikimin e programeve. Qëllimi i kësaj flete është të sigurohet që detyrimet në shpenzime që nuk janë respektuar në vitin financiar paraardhës të dokumentohen si duhet në dokumentet buxhetore dhe financiare për vitin pasues.

Fondet e mbartura janë rezultat i diferencës midis shumës së parashikuar nga programi/aktiviteti në vitin buxhetor në vazhdim dhe shpenzimeve të kryera realisht. Nëse diferenca është pozitive, departamenti i financës duhet të kujdeset të identifikojë arsyen e diferencës. Ndonjëherë arsyeja e tepricës është kursimi I realizuar nëpërmjet blerjes së mallrave dhe shërbimeve me një çmim më të ulët tregu nga ç'është përlogaritur fillimisht. Megjithatë në rastet e projekteve të investimeve kapitale, kur një shpenzim nuk është kryer për shkak të pengesave teknike ose kohore, mund të jetë me vend që të identifikohen fondet e mbartura si të angazhuara, për të vazhduar investimin capital në vitin e ardhshëm.

Lutemi vini re që fonde të tilla përsëri kanë nevojë të jenë të autorizuar në buxhetin vjetor (d.m.th. në formularin e kërkesës buxhetore) me qëllim që të bëhen të disponueshme për programin/aktivitetin.

Informacioni i futur në këtë fletë i shtohet automatikisht llogaritjes së shpenzimit të programit në formularët e kërkesës buxhetore.

3.10. Angazhimet (C5)

Për t'u plotësuar nga: Departamenti i Financës

Fleta C5 përvijon të gjitha angazhimet shumëvjeçare të marra në vitin buxhetor të kaluar ose në vazhdim nga programet dhe aktivitetet. Qëllimi është të shmangët krijimi i të prapambeturave dhe/ose zbrapsja nga objektivat buxhetore.

Autorizimi për angazhime paraprake për projekte investimesh kapitale dhe shpenzime të tjera periodike është I mundur në sistemin tonë buxhetor. **Megjithatë, që pagesat të bëhen efektive brenda çdo programi, janë të nevojshme autorizimet vjetore.** Kjo fletë shërben në radhë të parë për qëllime informacioni dhe dokumentacioni. Shifrat për angazhimin futen automatikisht si informacion në formularët përkatës të kërkesës buxhetore.

3.11. Tavanet (D1)

Për t'u plotësuar nga: Departamenti i Financës

Tavanet përdoren nga autoritetet politike, d.m.th. nga kryetari i bashkisë dhe këshilli, për ta orientuar strategjikisht buxhetin e departamenteve të linjës në vijë ngjitesë. Për këtë qëllim, tavanet duhet të caktohen nga autoritetet politike në një fazë të hershme të procesit të hartimit të buxhetit. Tavanet duhet të jenë në përputhje me përparësitë strategjike të NjQV, të bazuara në planin ekzistues të zhvillimit strategjik PZhS. Veç kësaj, tavanet duhet të respektojnë caqet financiare të NjQV. Procesi i përlogaritjes së burimeve sipas E1 deri në E5 do të nxjerrë në dritë këto kufizime financiare.

Është e rëndësishme që tavanet t'u komunikohen departamenteve të linjës sa më shpejt që të jetë e mundur.

IPF përdor një tavan të përgjithshëm për çdo program dhe brenda programit janë caktuar tri lloje nëntavanesh; i pari është për pagat dhe sigurimet shoqërore, i dyti – për blerjet e mallrave dhe shërbimeve (konsumi përveç kompensimit të stafit), i treti – për investimet kapitale. Ndërkohë që tavanet i parë dhe i dytë janë tavane maksimale për konsum, i treti përbën një kërkesë minimale për investimin capital. Tavani i investimit capital është mbetja nga tavani i përgjithshëm për të gjitha funksionet minus dy tavanet e konsumit. Kur këta dy tavane janë përdorur, kreu i NjQV, së bashku me këshillin, mund të drejtojnë ndarjen strategjike të burimeve sipas funksioneve me tavane të përgjithshme; veç kësaj, autoritetet politike mund të nxisin përparësitë investuese dhe t'i mbajnë nën kontroll shpenzimet e stafit me nëntavanet.

Departamenti i Financës përpunon pjesën e verdhë të formularit D1. Niveli minimal i investimit kapital llogaritet automatikisht. Informacioni për tavanet futet automatikisht në formularët e kërkesës buxhetore. Tavanet janë përcaktuar në terma absolute. Mund të gjeni një ekstrakt nga formulari "D1 Tavanet" në Figura 6.

Ka tri kërkesa për caktimin e tavaneve:

- Së pari, është absolutisht e domosdoshme një përlogaritje e kujdesshme dhe e besueshme e burimeve tërësore buxhetore të NjQV për të gjitha vitet e buxhetit afatmesëm. Ky informacion prodhohet në seksionin pasue E1 të IPF.
- Së dyti, NjQV ka nevojë për një strategji të zhvillimit vendor. Vetëm atëherë, tavanet mund të përcaktohen në mënyrë strategjike.
- Së treti, vullneti politik për të drejtuar procesin e buxhetit afatmesëm dhe vjetor në mënyrë strategjike duhet të jetë real.

Figura 6: D1 - Tavanet

(D1) CEILINGS				
		2018	2019	2020
		Budget year t+1	Budget year t+2	Budget year t+3
Program 1	011 Executive and legislative organs, financial, fiscal, external			
Saleries and social insurance		12,000	13,000	14,000
Other current expenditures		6,000	6,000	6,000
Capital investments		4,000	4,000	4,000
Overall ceiling		22,000	23,000	24,000
Program 2	013 General services			
Saleries and social insurance				
Other current expenditures				
Capital investments		0	0	0
Overall ceiling				

3.12. Premisa Makroekonomike (D2)

Premisat makroekonomike të formularit D2 japin informacion për shifrat përkatëse të përlogaritura nga konteksti makroekonomik, të cilat prekin buxhetin afatmesëm. Ky informacion përdoret në çdo fazë të procesit të hartimit të buxhetit, d.m.th. përgatitjen e buxhetit, vlerësimin e propozimit për buxhetin dhe miratimin e tij, ekzekutimin e buxhetit dhe kontrollin e mëvonshëm. Këto premisa janë kyçe për procesin e buxhetit; ato duhet të bazohen në përlogaritjet e institutive parashikuese të kualifikuara dhe të njohura përgjithësisht dhe të konfirmohen në nivel politik, d.m.th. nga kryetari i bashkisë, përpara se të bëhen zyrtare. Në shumicën e rasteve, premisat makroekonomike të NjQV mund të mbështeten në premisat e planifikimit të përdorura nga Ministria e Financave. Këto premisa u bëhen të njohura NJQV-ve nga Ministria e Financave çdo vit. Megjithatë rritja ekonomike ose inflacioni mund të jenë më të larta se mesatarja kombëtare në zonat me rritje të shpejtë ekonomike. E kundërta mund të ndodhë në zonat rurale të vendit. **Rekomandohet që të pasqyrohen premisat e planifikimit dhe të përshtaten ato në mënyrë të matur me realitetet vendore.** Kur premisat e planifikimit devijojnë nga përlogaritjet kombëtare, arsyet duhet të shpjegohen mirë.

Lutemi të vihet re që **premisat makroekonomike nuk përdoren automatikisht për përlogaritjen e të ardhurave ose shpenzimeve.** Çdo ent buxhetor duhet ta marrë parasysh këtë informacion dhe të vlerësojë ndikimin e inflacionit të parashikuar, rritjes reale ekonomike netj. Mbi të ardhurat dhe shpenzimet nën kontrollin e tij të drejtpërdrejtë.

Departamenti i Financës plotëson informacionin për premisat makroekonomike dhe ua komunikon të gjitha departamenteve të interesuara të linjës, kur departamenteve të linjës u kërkohet hartimi i buxhetit me prirje ngjithëse.

IPF paracakton gjashtë tregues ekonomikë; ka vend për tregues shtesë që konsiderohen të rëndësishme për NjQV-të.

Formulari “D2 Premisa makroekonomike” është paraqitur në Figura 7.

Figura 7: D2 - Premisa Makroekonomike

(D2) MACROECONOMIC ASSUMPTIONS						
	2015	2016	2017	2018	2019	2020
	Year t-2 (actuals)	Last year (actuals)	Current year (expected)	Year t+1 (expected)	Year t+2 (expected)	Year t+3 (expected)
Inflation rate		3,00%	4,00%	3,00%	3,00%	3,00%
Real economic growth rate		1,00%	2,00%	2,00%	3,00%	3,00%
Wage growth rate (nominal)		3,00%	4,00%	4,00%	4,00%	4,00%
Interest rate (3 months)		1,00%	1,00%	1,00%	1,00%	1,00%
Interest rate (5 years)		2,00%	2,00%	2,00%	2,00%	2,00%
Exchange rate (end of year) amount of lek for 1 euro	130,00					

3.13. Përlllogaritja e të Ardhurave I: Taksa (E1)

Për t'u plotësuar nga: Departamenti I të Ardhurave

Formulari E1 përdoret për të parashikuar të gjitha klasat e të hyrave vendore. Informacioni për disa burime të hyrash nuk do të jetë objekt i përlllogaritjeve vendore, si të dhënat për grantet sub-kombëtare që komunikohen nga Ministria e Financave. Disa burime të tjera, në veçanti burimet e veta të të ardhurave, duhet të përlllogariten gjatë procesit të bërjes së buxhetit. Së fundi, vija e mbledhjes e këtij formulary tregon burimet e përgjithshme buxhetore për çdo vit. Ajo paraqet gjithashtu subtotalet sipas llojit të të ardhurave; d.m.th. totali i taksave, totali i tarifave, totali i granteve etj.

IPF kërkon që cdo taksë dhe tarifë të përlllogaritet më vete. Sidoqoftë, procedura është mjaft e ngjashme për secilën prej tyre. Megjithatë, faktorët që mund të kenë impact mbi taksat nuk janë gjithmonë të njëjtët me ato që kanë impact për tarifat.

IPF merr parasysh pesë faktorë ndikues mbi taksat, si më poshtë: (1) rritja reale ekonomike, (2) inflacioni; (3) rritja e popullsisë, (4) rregullimi (modifikimi ligjor i ligjit të taksave), (5) përdorimi i përmirësuar i potencialit të taksave, (6) ndryshimet e nivelit të taksave; (7), të tjera.

Për fat të keq, informacioni për faktorët ndikues nuk është i përkryer; një pjesë e tij mund të merret nga premiset ekonomike, por një pjesë duhet supozuar. Kjo është vështirësia e parë. Tjetër, specialistët e taksave të NjQV-ve duhet të vlerësojnë ndikimin e secilit prej faktorëve ndikues mbi secilën taksë. Kjo është vështirësia e dytë. Është e qartë që disa faktorë input janë më të rëndësishëm për disa taksa se për të tjerat. Për shembull, rritja ekonomike shpresohet të ketë ndikim pozitiv mbi taksën e ndikimit në infrastrukturë, por jo në taksën e ndërtimit që është një taksë e sheshtë. Megjithatë, për të vlerësuar masën e këtij ndikimi mbi

një taksë të caktuar kërkohet një përvojë e madhe. Përdorimi i aftësive statistikore nuk mund ta zëvendësojë përvojën. Ka vetëm një rrugë për ta bërë këtë: të provosh, të diskutosh për gabimet në përllogaritje dhe të mësosh prej tyre.

Në Figura 8, mund të shikoni një ekstrakt të formularit “E1 – Taksa”; këtu paraqitet informacion për dy taksa: e ndërtesave dhe e transaksioneve të pasurisë. Në pjesën e sipërme gjeni rubrikat për shtatë faktorët ndikues; sfondi i fushave është mbajtur i bardhë. Poshtë, në fushat e verdha, mund të plotësoni ndikimin e pritshëm të secilit prej faktorëve ndikues mbi taksën përkatëse për secilin vit. Ndryshimi në % I referohet gjithmonë vitit paraardhës; p.sh. ndryshimi i pritshëm për 2018-ën është ndryshimi në përqindje I pritshëm në krahasim me rezultatin e 2017-ës.

Figura 8: E1 - Taksat

	(C2) REVENUES, LAST YEARS AND CURRENT YEAR																
	2017	Impact of real economic growth in %	Impact of population growth in %	Estim. impact of regression in %	Estim. impact of other factors in %	Improved use of tax potential in %	Tax rate change in %	Base value of new revenue	2018	Impact of real economic growth in %	Impact of population growth in %	Estim. impact of regression in %	Estim. impact of other factors in %	Improved use of tax potential in %	Tax rate change in %	Base value of new revenue	2019
	Current year (budget)																
VENUES FROM OWN SOURCES	182,550								194,167								194,094
VENUES FROM LOCAL TAXES	19,850								21,567								21,494
all tax on small business	-						1,000		1,000	10.0%							1,100
on immovable properties	1,850								2,203								2,608
Tax on buildings	1,250	2.0%			10.0%				1,403	1.5%				2.0%	20.0%		1,742
Tax on agricultural land	-								0								0
Tax on urban land	-						200		200				3.0%				206
Tax on property transactions	600								600	10.0%							660
all taxes on hotel service	-								0								0
on infrastructure impact of new buildings	6,000	2.0%	4.0%						6,365	1.0%				-10.0%			5,786
on tables	-								0								0
all Taxes on revenues derived from donations, inheritances, testaments and local lotteries	-								0								0
temporary taxes	12,000								12,000								12,000
temporary tax 1	-								0								0
temporary tax 2	-								0								0
VENUES FROM SHARED TAXES (GRANTS)	700								700								700

Të dyja rastet e paraqitura në figurën 8 janë të ndryshme.

- Taksa e parë, pra taksa e ndërtesës, është shembull për një taksë të vendosur rishtas. Le të supozojmë që në vitet e mëparshme nuk ka pasur të ardhura tatimore nga ky burim. Në rastin e një takes të vendosur rishtas, përdorni fushat në ngjyrë ulliri për vitin e futjes së taksës dhe vëllimin e pritshëm për vitin e parë. Shënoni vëllimin për vitin e parë – në shembullin tonë viti I futjes së taksës së re është viti t+1 - 2018. Ne aktualisht jemi në vitin t; ky është viti I buxhetit në vazhdim. Pra, t+1 është viti pas këtij. Për këtë arsye ju duhet të vlerësoni ndikimin e faktorëve ndikues vetëm për vitet t+2 dhe t+3, siç është bërë në shembullin tonë.
- Taksa e dytë, d.m.th. taksa e transaksionit të pasurisë, është një shembull për një taksë që ekziston tashmë. Ju i gjeni të ardhurat e kësaj takse për vitin e kaluar dhe vitin në vazhdim në përputhje me pasqyrën financiare vjetore dhe rezultatin e pritshëm të buxhetit të vitit në vazhdim në fushën portokalli në rreshtin e parë të kësaj takse. Në këtë rast, pikënisja për parashikimin është rezultati i pritshëm i vitit në vazhdim. (Mos përdorni të dhëna nga plani I vitit në vazhdim, kjo mund të jetë çorientuese). Plotësoni përqindjen e pritshme të impaktit të faktorëve përkatës për vitet e ardhshme. Në shembullin tonë ne marrim dy faktorë ndikues për vitin e parë dhe tre për vitin e dytë:
 - o Supozojmë që do të ketë një rritje prej 2% në mbledhje, për shkak të rritjes së pritshme ekonomike prej 4% e cila mund të stimulojë transaksionet e pasurisë me 50% të rritjes reale ekonomike, pra 2%.

- Faktori i dytë ndikues është potenciali I përmirësuar i mbledhjes taksave. Ne kemi përmirësuar administrimin e taksave në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve të fundit dhe po ndërtojmë një databazë të saktë, duke kërkuar të vendosim një sistem faturimi. Supozojmë që këto përpjekje do të ecin përpara vitin e ardhshëm dhe ne do të rrisim mbledhjen e taksave me 10% në t+1 dhe 5% në t+2 dhe t+3..
- Për vitin t+2, qeveria është angazhuar ta ndryshojë nivelin e taksës me 20% brenda vitit t+1.

Nëse një taksë rresht së ekzistuari në vitin t+1, përdor faktorin –100% nën ndryshimin e nivelit të taksës.

Rezultati i përlogaritjes së çdo takse (d.m.th. i grumbullimit të prishëm vjetor) gjendet në kutitë në ngjyrë argjendi në anën e djathtë të formularit.

Për të gjitha taksat e tjera të mbetura, procedura e parashimit mbetet e njëjta.

3.14. Përlogaritja e Burimeve: Taksat e Ndara (E1)

Në teori të njëjtët tregues të përdorur për të përlogaritur modelet e grumbullimit të taksave të veta duhet të zbatohen edhe për taksat e përbashkëta. Por ka shumë të ngjarë që inputet për grumbullimin e prishëm të taksave të përbashkëta të transmetohen drejtpërdrejt nga Ministria e Financës. Në këtë rast, ju thjesht duhet fusni përqindjen e rritjes në kolonën e ndikimit të përlogaritur të faktorëve të tjerë.

Në mënyrë alternative, ju mund të këshilloheni me buxhetin kombëtar, për të parë si janë përlogaritjet për taksat kombëtare dhe të përbashkëta. Për të llogaritur përafërsisht se çfarë do të marrë bashkia juaj, mund të përdorni trendin e mbledhjes kombëtare të taksave/ponderuar me pjesën që ka marrë historikisht bashkia juaj. Plotësojeni edhe këtë informacion nën ndikimin e përlogaritur të faktorëve të tjerë.

3.15. Përlogaritja e Burimeve: E1: Tarifat

Fleta E1 përdoret për përlogaritjen e të gjitha klasave të tarifave. Seksioni për tarifatat është ndërtuar në mënyrë të ngjashme me seksionin për përlogaritjen e taksave. Ajo që është shpjeguar atje është e zbatueshme edhe këtu. Sidoqoftë, faktorët influencues nuk janë të njëjtët.

Për tarifatat, IPF merr parasysh pesë faktorë më impact potencial: (1) përdorimi i përmirësuar i potencialit nga tarifatat; (2) rregullime ligjore; (3) rritja e volumit të aktivitetit; (4) rritja e tarifës për njësi; (5) të tjera.

Një ekstrakt i formularit E1/seksioni i tarifave është paraqitur në Figura 9. Tarifa e pastrimit është përdorur si shembull për një taksë që ekziston tashmë për bizneset, por që është future rishtaz për familjet. Do të bëhen përpjekje për shfrytëzimin më të mirë të potencialit nga tarifatat duke përmirësuar mbledhjen e tarifave. Për më tepër, planifikohet të zgjerohet fusha e shërbimit; cka gjithashtu do të gjenerojë tarifa shtesë.

Figura 9: E1- Tarifat

		(C2) REVENUES: LAST YEARS AND CURR								
		2017	Impact of real economic growth in %	Impact of population growth in %	Estim. impact of regulation in %	Estim. impact of other factors in %	Improved use of tax potential in %	Tax rate change in %	Base value of new revenue	2018
		Current year (budget)								
	REVENUES FROM OWN SOURCES	182,550								194,655
3	REVENUES FROM LOCAL TARIFFS	32,000								36,388
3.1	Fee on waste management	4,000								4,488
3.1.1	Fee on cleaning for families	-								0
3.1.2	Fee on cleaning for institutions	-								0
3.1.3	Fee on cleaning for businesses	4,000				10.0%		2.0%		4,488
3.2	Fee for waste collection and disposal	-								0

3.16. Përlllogaritja e Burimeve: Të Ardhura Jo-tatimore (E1)

Përlllogaritja për të ardhurat jotatimore ndjek teknikisht të njëjtën logjikë si taksat dhe tarifrat. Por ka shumë të ngjarë që faktorët ndikues të jenë mjaft më të kufizuar sesa në rastin e taksave.

Figura 10 tregon një shembull llogaritjeje për të ardhurat nga qiraja nga asetet, nga ndërmarrjet në pronësi të NjQV dhe shitja e të mirave dhe shërbimeve. Këto vlerësime duhet të bazohen në përvojat e viteve të kaluara dhe vlerësime teknike; hyrja e drejtpërdrejtë e vlerësimit është mundësuar. Në mënyrë të ngjashme, të hyrat nga huaja dhe të mbarturat mund të futen në seksionet C dhe D të formularit E1.

Figura 10: E4 – Të Tjera

XXXX FUT FIGURËN - FILE I DËMTUAR

3.17. Përlllogaritja e të Ardhurave nga Buxheti i Shtetit (transfertat) dhe Huatë (E1)

Për t'u plotësuar nga: Departamenti i Financës

Është i nevojshëm informacion paraprak për të specifikuar flukset e ndryshme nga transfertat e kushtëzuara, kontributet e donatorëve, huatë. Informacioni përkatës për transfertat për tre vitet e ardhshme jepet çdo vit nga Ministria e Financave.

Ky seksion është përpunuar nga Departamenti i Financës. Gjithsesi rekomandohet fuqimisht që Departamenti i Financës të këshillohet me departamentet e linjës lidhur me përlllogaritjen e transfertave të kushtëzuara dhe kontributet e donatorëve. regarding the estimations for conditional transfers, specific transfers and donor contributions.

3.18. Formularët e Kërkesës Buxhetore FKB (FKB1 - FKB29)

Për t'u përpiluar nga: Kreu i departamentit përkatës të linjës/njesisë

Formularët e kërkesës buxhetore FKB përdoren nga departamentet e linjës për të përgatitur kërkesat e tyre buxhetore Brenda caqeve të përcaktuara nga kryetari i bashkisë dhe të miratuara nga këshilli bashkiak. Duke u bërë kjo, procesi i gjerë nga lart poshtë i përgatitjes së

buxhetit kombinohet me një proces të detajuar ngjitës. Rekomandohet fort që departamentet e linjës të kenë përgjegjësi në procesin e hartimit të FKB-ve, kur janë të interesuar. Kështu do të zhvillohet një proces këshillimi brenda departamenteve të linjës dhe do të përfshiheshin të gjitha palët e interesuara. Kjo procedurë garanton që të respektohen plotësisht shqetësimet e ekzekutuesve, kur përpunohet buxheti; duke u bërë kjo, buxheti bëhet më realist dhe kuptohet më mirë në vijën e parë.

Është themelore që departamenteve të linjës t'u jepet kohë e mjaftueshme për të përgatitur kërkesat e tyre buxhetore. Sipas standardeve ndërkombëtare, një kuadër kohor prej të paktën 4 javësh do të ishte ideal. Ky kuadër kohor duhet të përfshihet në kalendarin e buxhetit të NjQV-ve.

Në përputhje me klasifikimin funksional-programatik, ka gjithsej 29 FKB; për secilin program përdoret një FKB e veçantë. Për të gjurmuar informacionin, aktivitetet janë kufizuar në maksimumi katër për çdo FKB, siç është përcaktuar në formularin B3 të strukturës funksionale.

FKB përbëhet nga katër hapësira (shih Figura 11):

- (1) Titulli (rreshti 2 deri 8)
- (2) Kuadri i kërkesës buxhetore (rreshti 14 deri 48) – vetëm rreshta output
- (3) Përputhja me tavanet (rreshti 50 deri 63)
- (4) Buxhetet e detajuara për çdo aktivitet/projekt (rreshti 66 deri në fund të faqes).
Lutemi, vini re që Figura 11 nuk e tregon këtë hapësirë për aktivitetin e dytë dhe të tretë! Paraqitet vetëm formati për aktivitetin e parë.

(1) Titulli i formularit: Tabelë vetëm output.

Hapësira e titullit paraqet informacionin e përgjithshëm të programit. Në rreshtin 2, gjeni emrin e programit, departamentin përgjegjës të linjës, emrin përkatës të programit. Në rreshtat 3 deri 7, tregohen aktivitetet/projektet e këtij programi dhe karakterizohen natyra dhe lloji i tyre. I gjithë ky informacion futet automatikisht në FKB nëpërmjet fletës B3. Në këtë hapësirë nuk duhet bërë asgjë në mënyrë manuale.

(2) Kuadri i kërkesës buxhetore

Hapësira e kuadrit paraqet shpenzimet e përgjithshme për programin:

Seksioni majtas (kolonat A deri në G) paraqesin një kuadër të shpenzimeve të përgjithshme për programin (pra shpenzimet bruto) Një ndarje e shpenzimeve bruto është paraqitur në përputhje me klasifikimin ekonomik në tri kategori kryesore: paga, shpenzime për mallra dhe shërbime të blera (konsum jo për paga) dhe investime kapitale.

Pjesa e sipërme e seksionit në të djathtë paraqet të ardhurat e mbartura nga programi (I15: O29), që mund ta kenë burimin tek tarifat dhe tarifat e shërbimit kushtuar programit; ose transfertave të mbartura.

Në pjesën fundore të seksionit, djathtas, (I32: O48) paraqitet një kuadër I kërkesës buxhetore për këtë program nga buxheti shumëfunksional i bashkisë – d.m.th. shpenzimet për programin. Shpenzimet neto buxhetore janë kompiluar si diferencë midis shpenzimeve bruto (nevojat e përgjithshme për shpenzime) dhe të ardhurat totale nga programi (nga tarifat dhe të ardhurat e mbartura).

Sugjerim: Lutemi të vihet re që jot ë gjitha programet buxhetore do të kenë të ardhura/të hyra neto të mbartura. Përgjithësisht kjo do të ndodhë në ato programe ku janë vendosur tarifa shërbimi (për shembull, pastrimi); ose kur merren grante të mbartura. Për shumicën e programeve buxhetore shpenzimet bruto dhe neto do të jenë të barabarta dhe këto do të financohen nëpërmjet buxhetit shumëfunksional të bashkisë.

Kjo hapësirë kompilohet automatikisht. Informacioni në fushat portokalli vjen nga informacioni i mbledhur nga Departamenti i Financës; shifrat në fushat a argjenta janë llogaritur mbi bazën e informacionit në hapësirën 4 të FKB. Në këtë hapësirë asgjë nuk duhet bërë në mënyrë manual.

(3) Përputhja me tavanet

Ky seksion kontrollon nëse shpenzimet e përgjithshme për programin janë brenda tavanit të miratuar nga këshilli bashkiak.

1. Të dhënat janë llogaritur automatikisht nga informacioni i detajuar i futur në seksionet e shpenzimeve për aktivitetet të FKB; krahasuar me tavanet sikurse janë përfshirë në fletën D1 (Tavanet).

Fleta krahason tavanin e përgjithshëm për programet me shpenzimet e përgjithshme, si dhe kategoritë ekonomike të shpenzimit me tavanet përkatëse tëp agave, me shpenzimet e tjera operacionale dhe shpenzimet kapitale.

Të dhënat llogariten automatikisht. Bazuar në këtë, kolona L do të krijojë "OK!", nëse shpenzimet janë në linjë me tavanet.

Në rastin kur shpenzimi i parashikuar e ka tejkaluar tavanin e dhënë, në kolonën L do të shfaqet shenja "STOP!" Zyrtarët do të duhet të rishikojnë premisat e shpenzimit në nivelin e aktivitetit, për të siguruar përputhjen.

(4) Buxheti i detajuar për çdo aktivitet/projekt

Sikurse është thënë, çdo FKB lë hapësirë vetëm për një numër të kufizuar aktivitete. Në rreshtin e titullit, që është nënvizuar me ngjyrë të bruztë (#66, #104and #142), informacioni futet automatikisht informacioni i mëposhtëm: kodi i programit, emri i programit, numri i aktivitetit, emri i aktivitetit.

Poshtë rreshtit të titullit, gjeni tri nënhapësira:

- (i) Ana e majtë i kushtohet përlllogaritjes së shpenzimeve,
- (ii) Ana e djathtë për përlllogaritjen e të ardhurave,
- (iii) Dhe poshtë (rreshti 95 deri 101), është lënë vend për shpjegim.

Figura 11: FKB1 deri FKB29 – Formulari i Kërkesës Buxhetore

Directorate / Department	Name of program	Head of program	Activity: obligatory / additional	Activity: own / delagated / specially transferred
Program 1	011 Executive and legislative organs, financial, fiscal, external affairs	Fran		
Activity 1a	Planning, management and administration		obligatory	own
Activity 1b	Financial and fiscal affairs		obligatory	own
Activity 1c	Amortisation of arrears		obligatory	own
Activity 1d	General public services		obligatory	own
Activity 1e	ABC		additional	own

OVERVIEW OF BUDGET REQUEST						
Program 1	011 Executive and legislative organs, financial, fiscal, external affairs					
EXPECTED EXPENDITURES				EXPECTED REVENUES		
	2015	2016	2017	2018	2019	2020
EXPECTED EXPENDITURES	92,000	30,000	45,000	51,000	52,000	53,000
ESTIMATED REVENUE FROM FEE						
ESTIM. REVENUE FROM FEE	16,000	25,000	40,000	41,500	44,000	47,000
ESTIMATED EARMARKED REVENUES						
Conditional grants				2,000	5,000	500
Contributions				0	0	0
Earmarked carry overs				5,500	4,400	3,300
Further sources (incl. fines)				0	0	0
ESTIM. EARMARKED REV.	23,500	35,000	48,500	7,500	9,400	3,800
EXPECTED REVENUES	39,500	60,000	88,500	49,000	53,400	50,800
NET AMOUNT REQUESTED						
NET AMOUNT REQUESTED	52,500	-30,000	-43,500	2,000	-1,400	2,200

EXPECTED EXPENDITURES					
	2015	2016	2017	2018	2019
DIRECT COSTS FOR PROJECTS & CAP. INVESTMENTS					
salaries	600		14,000	14,000	13,000
social insurance	601		0	0	0
goods & other services	602		0	0	0
subsidies	603		0	0	0
current domestic transfers	604		0	0	0
current international transfers	605		0	0	0
transfers to individuals & families	606		0	0	0
capital investments	230 / 231		1,000	1,000	0
reserves	609		0	0	0
interests for direct loans or bonds	650		0	0	0
other	69 / 7		0	0	0
DIRECT COSTS FOR PROJECTS & CAP.			15,000	15,000	13,000
RECURRENT COSTS					
salaries	600		3,000	3,000	3,000
social insurance	601		0	0	0

Le të shohim tani më nga afër nënhapësirën (i) përlllogaritje shpenzimesh dhe (ii) përlllogaritje të ardhurash për çdo aktivitet.

(i) Shpenzimet sipas formularit të kërkesës së buxhetit

Nënhapësira për përlllogaritje shpenzimesh është ndarë sërish në tri seksione (shi Figura 12): Pjesa e sipërme (rreshti 71) përdoret për të përlllogaritur shpenzimet bruto për një aktivitet; seksioni lart (rrashtat 74 deri 85) i kushtohet një përlllogaritjeje të ndarë të kostove direkte të projekteve më të mëdha, si investimet kapitale; së fundi, seksioni më poshte, (rreshtat 87 deri 99) përdoret për përlllogaritjen e ndarë të kostove periodike të aktivitetit të financuar nga buxheti.

Figura 12: Përlllogaritja e Shpenzimeve për Aktivitet/Projekt

	A	B	C	D	E	F	G
67	Activity 1a	Planning, management and administration					
68	EXPECTED EXPENDITURES						
69		2015	2016	2017	2018	2019	2020
70							
71	EXPECTED EXPENDITURES	8,000	4,000	7,000	7,000	7,000	7,000
72							
73	EXPECTED EXPENDITURES						
74	DIRECT COSTS FOR PROJECTS & CAP. INVESTMENTS						
75	Salaries	600			1,000	1,000	0
76	Social insurance	601					
77	Goods & other services	602					
78	Subsidies	603					
79	Current domestic transfers	604					
80	Current international transfers	605					
81	Transfers to individuals & families	606					
82	Capital investments	230 / 231			1,000	1,000	
83	Reserves	609					
84	Interests for direct loans or bonds	650					
85	Other	69 / ?					
86	DIRECT COSTS FOR PROJECTS & CAP.	0			2,000	2,000	0
87	RECURRENT COSTS						
88	Salaries	600			3,000	3,000	3,000
89	Social insurance	601					
90	Goods & other services	602					
91	Subsidies	603					
92	Current domestic transfers	604					
93	Current international transfers	605					
94	Transfers to individuals & families	606					
95	Capital investments	230 / 231					
96	Reserves	609					
97	Interests for direct loans or bonds	650					
98	Other	69 / ?		OKI	2,000	2,000	4,000
99	RECURRENT COSTS				5,000	5,000	7,000
100							
101	EXPECTED EXPENDITURES	8,000	4,000	7,000	7,000	7,000	7,000

➤ Shpenzimi i pritshëm: (Radha 71)

Shuma totale e shpenzimit të planifikuar për aktivitet duhet të ngarkohet në këtë seksion. Të dhënat nga buxheti i vitit të kaluar dhe në vazhdim do të importohen automatikisht nga informacioni I ngarkuar më parë.

➤ Kostot direkte për projektet dhe investimet kapitale vs. kostove periodike:

Tani le të kalojmë te dy sektorë shtesë të pjesës së shpenzimeve, që u kushtohen kostove direkte të projekteve dhe investimeve kapitale, nga njëra anë, dhe dy kostove periodike, nga ana tjetër. Këto dy hapësira ju lejojnë të ndani shpenzimet e parashikuara në përputhje me klasifikimin ekonomik. Në rastin e një investimi kapital dhe projekteve të tjera, pjesa e sipërme, pra kostot direkte, kanë më shumë peshë; në rastin e aktiviteteve në vazhdim, pjesa e poshtme është më e rëndësishme në shumë raste. Gjithsesi kini parasysh që edhe

investimet kapitale do të shkaktojnë kosto periodike vitet e ardhshme, sidomos në kuadrin e kostove të mirëmbajtjes dhe shpenzimeve të tjera operacionale në vartësi të natyrës së investimit kapital. Ndarja midis kostove të investimit capital, nga njëra anë, dhe kostove periodike, nga ana tjetër, është e nevojshme për shkak të tavanëve dhe kërkesave të raportimit. Po për këto dy arsye, është e nevojshme edhe një ndarje në kategori e klasifikimit ekonomik.

Lutemi mbani parasysh që, po të harroni të plotësoni këtë hapësirë, do të keni probleme me tavanet, në qoftë se ky instrument përdoret nga kryetari i bashkisë dhe këshilli. Veç kësaj, IPF do t'i fusë shpenzimet e pashpjeguara në kategorinë "Të tjera" në rreshtin 98, që përdoret si mbetje. Krahas kësaj, informacioni nga dy seksionet e informacionit për kostot përdoret edhe për tabelat output. Kur nuk i plotësoni si duhet këto hapësira, detajet e planit financiar të bashkuar do të paraqitet në mënyrë të pasaktë dhe jot ë gjitha tabelat output mund të përdoren.

(ii) Seksioni mbi të ardhurat i formularit të kërkesës buxhetore

Tek seksioni mbi të ardhurave në formularin e kërkesës buxhetore vlerësohen dy klasa të ardhurash: tarifat dhe transfertat e mbartura. Të dyja klasat mund të lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin/projektin që shqyrtohet. Nën titullin e gjelbër, shuma neto e kërkuar rezulton si mbetje e shpenzimeve të pritshme për këtë aktivitet (ana e majtë e FKB, rreshti 101) dhe të ardhurave të pritshme në formën e tarifave dhe të ardhurave të mbartura (shih. Figura 13).

Figura 13: Përlllogaritja e të Ardhurave brenda Formularit të Kërkesës Buxhetore

	H	I	J	K	L	M	N	O
68	EXPECTED REVENUES							
69			2015	2016	2017	2018	2019	2020
70								
71	ESTIMATED REVENUE FROM FEE							
72	ESTIM. REVENUE FROM FEE		2,000	5,000	8,000	8,000	8,000	8,000
73								
74	ESTIMATED EARMARKED REVENUES							
75	Conditional grants					2,000	1,000	500
76	Contributions							
77	Earmarked carry overs					0	0	0
78	Further sources (incl. fines)							
79	ESTIM. EARMARKED REV.		3,000	6,000	9,000	2,000	1,000	500
80								
81	EXPECTED REVENUES		5,000	11,000	17,000	10,000	9,000	8,500
82								
83								
84								
85	NET AMOUNT REQUESTED							
86								
87	NET AMOUNT REQUESTED		3,000	-7,000	-10,000	-3,000	-2,000	-1,500
88								
89								
90	Commitments	Total Amount per Activity				1,000	2,000	2,500
91	Purpose	Capital investments				1,000	1,000	
92		Goods & other services					1,000	2,500
93		Further purposes						
94						OK	OK	OK
95	Technical explanations							
96	2018							
97								
98	2019							
99								
100	2020							
101								

Le t'i hedhim një sy tani përlllogaritjes së të ardhurave nga tarifat dhe të ardhurave të mbartura.

Në seksionin e të ardhurave të pritshme, në tarifat, të dhënat për mbledhjet e viteve të mëparshme (d.m.th. kontributet për porogramet) ngarkohen automatikisht. Plotësoni vëllimin e pritshëm për periudhën buxhetore. Lutemi vini re që të dhënat në këtë seksion janë identike me të dhënat e future në fletën "Përlllogaritja e të ardhurave".

Përlllogaritja e transfertave të mbartura bazohet plotësisht në informacionin e NjQV dhe të departamenteve të saj të linjës. I gjithë informacioni i dftisponueshëm do të përdoret nga ekspertët, për parashikuar në mënyrë realiste se ç'mund të pritët. Zyrtarët duhet të fusin të dhënat për a) grantet e kushtëzuara për programin/aktivitetin; contribute të tjera (d.m.th. donacione); burime të tjera (d.m.th. gjoba). Të dhënat për të mbarturat në destinacion do të ngarkohen automatikisht, të importuara nga fletët përkatëse.

Totali i të dyja burimeve të të ardhurave, tarifave dhe transfertave të mbartura, mbidhen dhe rezultati del në kutitë djathtas “Të ardhurave të pritshme”.

Është themelore për departamentet e linjës që të kenë një pamje të qartë për çka mund të jep resin nga përdoruesit në kuadrin e tarifave dhe nga palë të treat në formën e transferatve të mbartura. Sa më e lartë kjo e ardhur direkte, e lidhur me aktivitetin, aq më e ulët do të jetë shumata neto e kërkuar. Lutemi të jeni të vetëdijshëm për marrëdhënien e mëposhtme: kur një aktivitet e caktuar zvogëlohet, atëherë shpresohet që të zvogëlohen edhe shpenzimet për këtë aktivitet. Pori ë shumë raste do të pakësohen edhe tarifat, si dhe të ardhurat e mbartura. Prandaj, nëse zvogëloni një aktivitet, të themi 20%, atëherë shpenzimet mund të zbersinndoshta 5% (jo 20% për shkak të kostove fikse). Veç kësaj, kur zbret e ardhura e lidhur drejtpërdrejt me aktivitetin, kursimet në kuadrin e kërkesës neto të buxhetit janë shumë më të ulëta se 20%, ndoshta 10%, në vartësi të rëndësisë dhe raportit me këto të ardhura të drejtpërdrejta të lidhura me aktivitetin.

Zyrtarët e buxhetit në departamentet e linjës duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe potencialin e të ardhurave të drejtpërdrejta, të lidhura me veprimtaritë. Kjo e forcon pozitën e një departamenti të linjës dhe kursen të ardhurat e drejtpërdrejta të NjQV. Këto kursime forcojnë potencialin e NjQV dhe përmirësojnë më tej shërbimet publike dhe e bëjnë më tërheqëse NjQV.

Zyrtarët e buxhetit në departamentet e linjës dhe të Departamentit të Financës duhet të mblidhen së bashku dhe të sigurohen që përlllogaritjet e departamenteve të linjës për të ardhurat e lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet janë në përputhje me përlllogaritjet e Departamentit të Financës për tarifat dhe të ardhurat e mbartura. FKB e IPF ndihmon që këto përlllogaritje të departamenteve të ndryshme të NjQV të bëhen transparente dhe të krahasueshme; kjo është baza për të arritur koherencë në planifikimin financiar.

4. TË DHËNAT OUTPUT DHE INTERPRETIMI I TYRE (F1 - F16)

4

IPF prodhon dy klasa outputesh, tabela dhe grafikë. Skedat e fletëve për tabela janë të nënvizuara me të gjelbër të errët; për grafikët – në të gjelbër të lehtë.

Gjithsej, IPF prodhon 8 tabela dhe 8 grafikë, që mund të përdoren drejtpërdrejt për qëllime komunikimi. Orientimi i PBA 2017 bën sugjerime se cili informacion i IPF në cilin seksion të PBA mund të përdoret. Megjithatë kini kujdes në paraqitjen e këtyre tabelave dhe grafikëve. Për një audience më të gjerë bëjeni këtë në mënyrë përzgjedhëse. Mos e përmbysni audiencën me informacion tepër të rënduar. Përzgjidhni grafikët dhe tabelat që ju duken të rëndësishme. Nënvizoni në një koment se ç'është e rëndësishme të shihet dhe të dihet nga secili grafik apo tabelë që ju përzgjidhni për ta paraqitur.

IPF praqet kuadrin e burimeve buxhetore në tabelën F1. Shpenzimet janë paraqitur në mënyra të ndryshme:

- sipas klasifikimit të programeve (F2 deri F5),
- sipas klasifikimit të sektorëve (F6 & F7),
- sipas llojit të aktivitetit, d.m.th. e detyrueshme/shtesë ose e vetja/e deleguar/e transferuar rishtas (F8& F9),
- sipas klasifikimit ekonomik (F10&F11)
- zëra shpenzimesh specifike, si më poshtë:
 - Të prapambetura në fund të viti (F12)
 - Grafik i investimeve kapitale (F15)

IPF i paraqet rezultatet e bashkuara me shifra bruto dhe neto. Shifrat bruto informojnë audiencën për sasinë e përgjithshme të shpenzimeve të planifikuara. Shifrat neto tregojnë sa duhet paguar me paratë e taksave vendore dhe grantet me qëllim të përgjithshëm.

Veç kësaj, IPF paraqet një deklaram të përgjithshëm financiar (F13), pra, burimet totale buxhetore, shpenzimet totale dhe tepërcën e plotë ose tejkalimin e shpenzimeve.

Së fundi, në fletën F14, the IPF llogarit shifrat reale për 9 tregues financiarë (shih Table 2). Këta tregues duhet të përdoren për të vlerësuar nëse plani afatmesëm financiar ka një balancë të mirë financiare. Për interpretimin dhe vlerësimin e vlerave të treguesve, kërkohet një strategji financiare e NjQV me objektiva të qartë vlerash. Kjo strategji mund të jetë pjesë e PZhS; megjithatë një strategji e veçantë sektoriale mund të jetë më e përshtatshme, sepse kjo qasje ofron më shumë fleksibilitet.

Table 2: Tregues Financiarë

Treguesi	Interpretimi i mundshëm
Shpenzimet e përgjithshme/burimet e përgjithshme buxhetore	Nëse shpenzimet e përgjithshme janë më të larta se burimet e përgjithshme buxhetore, NjQV krijon humbje.
Të ardhura nga taksat dhe tarifa/ burimet e përgjithshme buxhetore	Sa më i madh është ky raport, aq më e madhe është pavarësia vendore, nga njëra anë, por, nga ana tjetër, aq më e madhe është barra e taksave. Ekziston një kompromis midis dy problemeve të pavarësisë dhe barrës së ulët të taksave për qytetarët vendor. Në rastin e tarifave, që lidhen me dhënien e shërbimeve, qytetarët me të ardhura të ulëta e kanë më të vështirë të paguajnë tarifa.
Të ardhura të vetat/burimet e përgjithshme buxhetore	Tregues për pavarësinë dhe forcën fiskale të NjQV.
Investime kapitale/Shpenzimet e përgjithshme	Tregues për orientimin e zhvillimit të financave të NjQV.
Shpenzime personeli/Shpenzimet e përgjithshme	Tregues i efektshmërisë së administratës vendore
Hua afatgjata/burimet e përgjithshme buxhetore	Tregues i vartësisë financiare të NjQV
Hua afatgjata/ Të ardhura të vetat	Tregues i vartësisë financiare të NjQV
Pjesa e detyrimeve të pagesave të vonuara ndaj burimeve të përgjithshme buxhetore	Tregues i disiplinës fiskale të NjQV
Pjesa e shpenzimeve për politikën e kujdesit shoqëror ndaj shpenzimeve të përgjithshme	Tregues i orientimit pro të varfërve, politikë zhvillimi e NjQV

Korrektesa e tabelave dhe grafikëve të outputeve varet nga saktësia dhe karakteri i plotë i futjes së të dhënave në hapësirën e inputeve të IPF.

5. LISTA E TERMAVE TEKNIKË DHE SHKURTIMEVE

5

<i>Termi</i>	<i>Përkufizimi</i>
Aktiviteti	Proces në vazhdim që kryhet për të arritur një objektiv politikash
FKB	Formulari i Kërkesës Buxhetore, përdoret nga departamentet e linjës për të përgatitur një projektbuxhet për çdo program dhe veprimtari në fushën e përgjegjësisë së tyre
Tavanet	Kufiri maksimal (apo minimal) i lejuar të shpenzohet për një zë të caktuar. IPF jep tavanet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> - Tavani përgjithshëm për program (maksimumi i lejuar) - Tavani i pagave dhe sigurimeve shoqërore për program (maksimumi i lejuar) - Tavani i konsumit për program (blerje mallrash dhe shërbimesh) - Minimumi i kërkuar i investimeve kapitale
Kosto direkte projekti	Kostot për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, duke përfshirë menaxhimin e projektit. Shih edhe: Kosto periodike.
dldp	Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Vendor
Tregues financiar	Financial key figure used to assess the sustainability of local finances in an aggregated way
IPF	Instrumenti i Planifikimit Financiar
Shpenzime bruto	Shpenzimet e përgjithshme, duke përfshirë ato që mbulohen nga palë të tretat (tarifa përdorimi, grante të qeverisë qendrore, kontribute donatorësh etj.). Shih edhe: Shpenzime neto
HSLU	Hochschule Luzern, i.e. Lucerne University of Applied Sciences and Arts
ISB	Instituti i Studimeve Bashkëkohore, Tiranë

Premisa makroekonomike	Premisa planifikuese për zhvillimin ekonomik që prekin financat e NjQV-ve gjatë periudhës së planifikimit afatmesëm: rritja ekonomike, inflacioni, niveli interesave në afate të shkurtëra e të mesme, rritja e pagave
Afat i mesëm	Tre vjetët e ardhshëm
PBA	Programi i Buxhetit Afatmesëm
MoF	Ministra ef Financës
n.e.c.	E paklasifikuar gjetkë
Net expenditure	Shpenzimet e përgjithshme, duke përjashtuar çka mbulohet nga palë të treat (nëpërmjet tarifave të përdorimit, granteve të qeverisë qendrore, kontributeve të donatorëve etj.). Shih edhe: Shpenzime bruto.
Program	Fushë e politikave që kombinon detyra që pajtohen (të një NjQV). Programet përbëhen nga një ose më shumë aktivitete; ato drejtohen nga të njëjtat qëllime dhe objektiva politikë.
Kosto periodike	Kosto në vazhdim si efekt i aktiviteteve në vazhdim ose një strukture të re. Shembull: Kur ndërtohet një qendër shëndetësore, kjo kërkon staf, barna, ngrohje etj. Gjatë të gjitha viteve të mëvonshme. Shih edhe: Kosto direkte projekti
SDC	Sëiss Agency for Development Cooperation
Ndryshim strukturor	Zhvillim demografik, ligje të reja ose rregullime ligjore, procedura të reja etj. Që mund të ndikojnë mbi shpenzimet e programeve.
Të prapambetura	Pagesa që janë vonuar më shumë se 90 ditë kalendarike.
Të mbartura në destinacion	Fonde që kanë qenë premtuar dhe nuk janë dhënë deri në fund të vitit buxhetor. Këto fonde zakonisht duhet të rivendosen me të njëjtin qëllim në vitin tjetër buxhetor, përveç se kur angazhimi (subjekti) nuk ekziston më.
Angazhim	Angazhim buxhetor për detyrime financiare i marrë në formë të shkruar, përmes pjesëmarrjes në një marrëveshje kontraktuale.

6. ANEKS: PËRSHKRIM I PROGRAMEVE DHE AKTIVITETEVE

SEKTORI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

011: Organet Ekzekutive dhe Legjislative, Çështjet Financiare dhe Fiskale, Çështjet e Jashtme

Vështrim i përgjithshëm i programit		
<p>Programi siguron shërbime mbështetëse për kryetarin e bashkisë ose këshillin; ai siguron planifikimin e zhvillimit të bashkisë, menaxhimin e financave bashkiake, të burimeve të tjera bashkiake dhe të personelit, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun.</p>		
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	<ul style="list-style-type: none"> • Administrim, veprim ose mbështetje e zyrës së kryebashkiakut ose këshillit dhe komisioneve të këshillit ose të kryetarit të bashkisë • Komunikim i kryebashkiakut ose këshillit me publikun
01120	Çështje financiare dhe fiskale	<ul style="list-style-type: none"> • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve bashkiake dhe i borxhit bashkiak; funksionim i skemave tatimore; • Operacionet e thesarit të bashkisë, zyra e buxhetit, administrate e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit; • Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.
01130	Shërbimet e përgjithshme publike	<ul style="list-style-type: none"> • Administrim dhe veprim i shërbimeve të përgjithshme të personelit, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin politikave të përgjithshme për personelin • Planifikimi i përgjithshëm tërësor dhe shërbimet statistikore, duke përfshirë formulimin, bashkërendimin dhe monitorimin, në veçanti të Planeve Strategjike të Zhvillimit PSZh • Administrim dhe veprim i shërbimeve të tjera të përgjithshme, si shërbimet e centralizuara të prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të bashkisë, shfrytëzim i ndërtesave në pronësi apo të zëna nga bashkia, parqe qendrore automjesh, zyrave të shtypit dhe IT së centralizuar etj.

013: Shërbime të Përgjithshme Publike

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Me planifikimin territorial, varrezat dhe shërbimin e borxhit, programi përfshin shërbime të karakterit të përgjithshëm.		
01311	Planifikimi territorial	<ul style="list-style-type: none">• Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të përgjithshme lokale.• Analizë e zhvillimit të kërkesave të planit dhe lëshimi i lejeve për ndërtime të reja; zhvillimi i tokës etj.• Monitorimi i zhvillimit hapësinor
01312	Regjistri Civil	<ul style="list-style-type: none">• Regjistrimi i lindjeve, martesave, vdekjeve
01321	Varrezat dhe funeralet	<ul style="list-style-type: none">• Menaxhimi dhe mirëmbajtja e varrezave• Sigurimi i funeraleve dinjitoze dhe në kohën e duhur
01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	<ul style="list-style-type: none">• Pagesat e interesave dhe amortizimi i huave etj.

SEKTORI 3: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

031: Shërbimet Policore

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Shërbimet policore janë të nevojshme për ruajtjen e rendit publik dhe për parandalimin dhe zbulimin e krimeve. Në veçanti, policia është përgjegjëse për të mbrojtur jetën, lirinë dhe pronën e njerëzve.		
03140	Shërbimet e Policisë së Shtetit	<ul style="list-style-type: none">• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve policore, duke përfshirë regjistrimin e të huajve, lëshimin e dokumenteve të punës dhe udhëtimit, mbajtja e regjistrat të ndalimeve dhe statistikave që lidhen me punën e policisë, rregullimin e kontrollin e trafikut rrugor• Funkionimi i forcave policore të rregullta dhe ndihmëse

032: Shërbimet e Mbrojtjes nga Zjarri

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi përfshin luftën kundër zjarrit, parandalimin e zjarrit dhe përballimin e emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.		
03280	Lufta kundër zjarrit dhe mbrojtja civile	<ul style="list-style-type: none">• Administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve dhe shërbimeve të luftës kundër zjarrit;• Funkionimi i njërive të rregullta dhe ndihmëse zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe luftës kundër zjarrit të mbajtura nga autoritetet publike;• Funkionimi ose mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe luftës kundër zjarrit.• Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj.

036: Masa të Tjera për Rendin dhe Sigurinë Publike

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Ky program u kushtohet masave paraprake për të vendosur dhe ruajtur rendin dhe sigurinë publike në bashki.		
03600	Marrëdhëniet në komunitet	<ul style="list-style-type: none">• Veprimtari të bashkisë për të nxitur mirëkuptimin e ndërsjelltë dhe ndjenjën e përkatësisë brenda bashkisë dhe besimin dhe mbështetjen për autoritetet vendore
03602	Mbikëqyrja administrative vendore	<ul style="list-style-type: none">• Monitorimi i rendit dhe sigurisë publike• Monitorimi i qeverisjes vendore, për të siguruar që bashkia të plotësojë funksionet e saj dhe të mos shkelë ligjin, p. sh., nëpërmjet kontrollit të brendshëm

SEKTORI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE

041: Çështje të Përgjithshme Ekonomike, Tregtare dhe të Punës

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi bën përpjekje për të forcuar zhvillimin ekonomik vendor dhe punësimin.		
04111	Planet e zhvillimit ekonomik	<ul style="list-style-type: none">• Formulimi dhe zbatimi e monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare• Mbatja e kontakteve me nivelet më të larta qeverisëse dhe midis qeverisjes dhe biznesit, për të forcuar zhvillimin ekonomik
04131	Promovimi i biznesit vendor	<ul style="list-style-type: none">• Mbështetje marketing për bizneset vendore
04132	Mbështetje për zhvillimin rajonal	<ul style="list-style-type: none">• Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare dhe për të nxitur punësimin
04161	Tregjet	<ul style="list-style-type: none">• Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve lokale ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve

042: Bujqësia, Pyjet, Peshkimi dhe Gjuetia

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbështet zhvillimin e një prodhimi bazë të qëndrueshëm.		
04221	Kadastra	<ul style="list-style-type: none">• Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave
04222	Këshillim agronomik	<ul style="list-style-type: none">• Prodhimi dhe përhapja e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet bujqësore
04223	Veterinari	<ul style="list-style-type: none">• Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinare për bujqit
04240	Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	<ul style="list-style-type: none">• Ndërtim ose organizim i kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla
04260	Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	<ul style="list-style-type: none">• Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;• Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;• Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e licencave për prerje drurësh (hedhja e pemëve);• Organizim ose mbështetje për veprimtarinë rryllëzuese, kontrollin e insekteve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë;• Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;• Grante, hua, subvencione për të mbështetur aktivitetet tregtare pyjore• Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e

		<p>kullotjes</p> <ul style="list-style-type: none"> • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional i peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë
--	--	--

045: Transporti

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi siguron lëvizshmëri lokale të sigurtë dhe të rrjedhshme rrugore për të gjitha kategoritë e përdoruesve privatë të rrugëve dhe për transportin publik.		
04521	Ndërtim dhe mirëmbajtje rrugësh	<ul style="list-style-type: none"> • Funksionimi, përdorimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.);
04530	Studime për rrugët	<ul style="list-style-type: none"> • Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit ose për masa për lehtësimin e trafikut
04570	Transporti publik	<ul style="list-style-type: none"> • Kontraktimi i kompanive private të transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal • Mbikëqyrje dhe disiplinim i shërbimeve të transportit publik lokal nga kompanitë private (miratimi i tarifave për pasagjerët dhe i orëve dhe shpeshtësisë së shërbimeve etj.) • Ndërtim ose funksionim i sistemeve dhe strukturave jotregtare/ndërmarrje të transportit publik lokal • Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, orareve etj. të operacioneve të sistemit publik lokal të transportit • Grante, hua ose subvencione për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal

047: Industri të Tjera

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbështet zhvillimin e turizmit; veç kësaj, ai mund të përfshijë masat e mbrotjes nga përmytjet dhe ndërhyrjet për zbukurim (dekorim).		
04761	Zhvillimi i turizmit	<ul style="list-style-type: none"> • Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të turizmit vendor; promovim dhe zhvillim i turizmit vendor. • Funksionimi i zyrave turistike vendore etj.; organizim i fushatave publicitare, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaurës promovuese e të një natyre të ngjashme; • Mbledhje dhe botim i statistikave vendore për turizmin.
04741	Mbrojtja nga përmytjet	<ul style="list-style-type: none"> • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve që kanë të bëjnë me ndërtimin, shtimin, përmirësimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e strukturave për

		kontrollin e përmbytyjeve.
04742	Zbukurimi	<ul style="list-style-type: none">Realizimi i përmirësimeve pamore në hapësirat urbane të bashkisë, duke mbjellë lule, shkurre dhe pemë, duke zëvendësuar trotualet e prishura me material natyrore dhe duke instaluar drita rrugësh të stilit historik etj.

SEKTORI 5: MBROJTJA E MJEDISIT

051: Menaxhimi i Mbetjeve

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon grumbullimin, trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve. Ai përfshin fshirjen e rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj.		
05101	Shërbimet bashkiake të menaxhimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none">• Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve.• Grante, hua ose financime për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve.• Fshirje e rrugëve dhe pastrim i parqeve etj.

052: Menaxhimi i Ujërave të Zeza

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon funksionimin e sistemit të kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të zeza. Ai përfshin menaxhimin dhe ndërtimin e sistemit të kolektorëve, kanaleve, tubacioneve dhe pompave për të larguar të gjitha ujërat e zeza (ujin e shiut, ujërat shtëpiakë dhe ujëra të tjerë të ndotur).		
05201	Shërbime kanalizimi nga strukturat e MUZ	<ul style="list-style-type: none">• Administrim, mbikëqyrje, inspektim, vënie në funksionim ose mbështetje e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza• Grante, hua ose financime për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza

053: Zvogëlimi i Ndotjes

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon veprimtari që lidhen me mbrojtjen e ajrit dhe klimës, mbrojtjen e tokës dhe burimeve të nëndheshshme, mbrojtjen nga zhurma etj.		
05320	Programe për mbrojtjen mjedisore	<ul style="list-style-type: none">• Administrim, mbikëqyrje, inspektim, organizim ose mbështetje e veprimtarive që lidhen me zvogëlimin dhe kontrollin e ndotjes• Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë që lidhen me uljen dhe kontrollin e ndotjes• Ndërtim, mirëmbajtje dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të ndotjes

056: Mbrojtja Mjedisore, t.sh.a.

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon veprimtaritë dhe politikat tërësore për mbrojtjen mjedisore.		
05630	Formimi i vetëdijes mjedisore	<ul style="list-style-type: none">• Promovim i mbrojtjes mjedisore• Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm

		dhe statistikave për ndotjen dhe mbrojtjen mjedisore
05640	Administrimi i resurseve ujore	•

SEKTORI 6: STRUKTURAT E STREHIMIT DHE KOMUNITETIT

061: Urbanistika

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon veprimtaritë për planifikimin dhe zhvillimin e banesave të përshtatshme në bashki.		
06140	Strehimi vendor dhe urbanistika	<ul style="list-style-type: none">• Sigurimi i truallit të nevojshëm për ndërtime banesash; ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njërive banuese për publikun në përgjithësi ose për njerëz me nevoja të posaçme; eliminim i ndërtimeve të degraduara të lidhur me sigurimin e strehimit• Grante, hua ose financime për për mbështetur zgjerimin, përmirësimin ose mirëmbajtjen e stokut të banesave
06180	Planifikimi urban dhe strehimi	<ul style="list-style-type: none">• Formulim, administrim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve të lidhura me strehimin• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit• Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e strehimit

062: Zhvillimi i Komunitetit

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon veprimtari për zhvillimin dhe përmirësimin e kontekstit të jetesës.		
06210	Programe zhvillimi	<ul style="list-style-type: none">• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve për zhvillimin e komunitetit• Formulimi i planeve të zonimit dhe i rregullave të ndërtimit• Planifikimi i komuniteteve të reja ose i komuniteteve të rehabilituara• Formulim, administrim, bashkërendim dhe monitorim i politikave të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve që lidhen me shërbimet për komunitetin• Përgatitja e skemave për financimin e zhvillimeve të planifikuara
06260	Shërbimet publike vendore	<ul style="list-style-type: none">• Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimin e strukturave të tilla si shërbimet për publikun, shëndeti, arsimit, kultura, çlodhja etj. Për komunitetet• Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit

063: Furnizimi me Ujë

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi siguron ujë të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda bashkisë.		
06331	Furnizimi me ujë të pijshëm nga kapacitetet e MUN-ve	<ul style="list-style-type: none">• Administrim i problemeve të furnizimit me ujë; vlerësimi i nevojave të ardhshme dhe përcaktimi i mundësive• Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë• Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të MUN-se• Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë;• Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë

064: Ndriçimi i Rrugëve

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi siguron ndriçimin e rrugëve në bashki.		
06440	Ndriçim rrugësh	<ul style="list-style-type: none">• Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve

SEKTORI 7: SHËNDETËSIA

072: Shërbimet e Kujdesit Parësor

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi siguron kujdes shëndetësor thelbësor për të gjithë individët dhe familjet në bashki.		
07220	Shërbime shëndetësore parësore	<ul style="list-style-type: none">Mirëmbajtje dhe ndërtim i infrastrukturës së re për shërbim shëndetësor parësor

SEKTORI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA

081: Shërbime Çlodhëse dhe Sportive

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon veprimtarinë ose mbështetjen e strukturave për aktivitete argëtuese/çlodhëse, sportive dhe contribute financiare për promovimin e spoteve.		
08120	Parqe	<ul style="list-style-type: none">Vënie në funksionim ose mbështetje për struktura për veprimtari çlodhëse (parqe, plazhe, kampingje dhe vendqëndrimet përkatëse) të ofruara në bazë jotregtare
08131	Sport dhe zbavitje	<ul style="list-style-type: none">Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive aktive (fusha lojërash, fusha tenisi, pishina noti, korsi vrapimi, terrene golfi, ringje boksi, pista patinazhi, palestra etj.); mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportiveVënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive pasive (struktura për qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojëra me letra, lojëra në tavolinë etj.)Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe apo lojtarë individualë

082: Shërbime Kulturore

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi vë në funksionim ose mbështet strukturat kulturore dhe organizon ose mbështet ngjarjet kulturore në bashki.		
08220	Trashëgimia kulturore, monumentet, kopshtet zoologjike e botanike dhe bibliotekat	<ul style="list-style-type: none">Vë në funksionim ose mbështet monumentet, shtëpitë dhe vendet historike, kopshtet zoologjike dhe botanike, bibliotekat
08230	Art dhe kulturë	<ul style="list-style-type: none">Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore
08280	Veprimtaritë kulturore të muzeumeve, teatrove Ngjarje kulturore	<ul style="list-style-type: none">Vënie në funksionim ose mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e ekspozitaveProdhim, organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerts, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.)

SEKTORI 9: ARSIMI

091: Arsimi bazë dhe Parashkollor

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Program mbështet arsimin bazë dhe parashkollor, duke bërë të disponueshme dhe duke mirëmbajtur klasat shkollore dhe duke pagura rrogat për mësuesit parashkollorë.		
09121	Ndërtim dhe mirëmbajtje	<ul style="list-style-type: none">Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore
09122	Paga e edukatorëve të kopshteve dhe stafi mbështetës	<ul style="list-style-type: none">Mbulimi i pagave për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafin mbështetës
09123	Ushqimi i kopshteve	<ul style="list-style-type: none">

092: Arsimi i Mesëm

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbështet arsimin dytësor, duke siguruar dhe mirëmbajtur lokalet shkollore dhe duke paguar rrogat e stafit mbështetës.		
09131	Ndërtim dhe mirëmbajtje	<ul style="list-style-type: none">Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore
09132	Pagat e stafit mbështetës	<ul style="list-style-type: none">Mbulim i pagave për stafin mbështetës
09241	Arsimi profesional	<ul style="list-style-type: none">Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave të institucioneve të arsimit profesional (fjetoret)

096: Shërbimet Ndihmëse për Arsimin

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbështet arsimimin e fëmijëve me shërbime ndihmëse dhe inkurajon trajnimin e mëtejshëm të mësuesve.		
09660	Programe arsimore dhe trajnime për edukatorët/mësuesit	<ul style="list-style-type: none">Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollaveMbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve

SEKTORI 10: KUJDESI SHOQËROR

101: Sëmundje dhe Paaftësi

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi jep ndihmë në para ose në natyrë për personat e sëmurë apo të paaftë, për të kompensuar humbjen e të ardhurave nga një veprimtari ekonomike, për të lehtësuar akomodimin e tyre dhe për të mbështetur integrimin e tyre në tregun e punës dhe në jetën shoqërore.		
10140	Shërbime të kujdesit shoqëror për personat e sëmurë dhe të paaftë	<ul style="list-style-type: none">• Përfitime monetare ose në natyrë që zëvendësojnë plotësisht ose pjesërisht humbjen e të ardhurave gjatë një paaftësie të përkohshme për të punuar për shkak të sëmundjes ose dëmtimit• Përfitime në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.)• Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor• Përfitime në natyrë, si strehim, mundësisht vakte ushqimi që u jepen personave të paaftë në lokale të përshtatshme, ndihmë që u jepet personave të paaftë për t'i ndihmuar në detyrat e përditshme (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.), pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e paaftë, trajnim profesional e trajnim tjetër i dhënë për të nxitur rehabilitimin në punë dhe atë shoqëror të personave të paaftë, shërbime dhe përfitime të ndryshme dhënë personave të paaftë, për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse ose për të udhëtuar apo për të marrë pjesë në jetën e komunitetit• Administrim, vënie në funksionim ose mbështetje për skema të tilla të mbrojtjes shoqërore

102: Pleqëria

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi jep ndihmë në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të kompensuar humbjet e fitimeve nga një veprimtari ekonomike, për të lehtësuar jetën e tyre të përditshme dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre.		
10220	Sigurim shoqëror	<ul style="list-style-type: none">• Përfitime në para dhe përfitime në natyrë përballë rreziqeve të lidhura me moshën e kaluar (humbje e të ardhurave, mungesë pavarësie në kryerjen e detyrave të përditshme, pjesëmarrje e ulur në jetën shoqërore dhe komunitare etj.)• Përfitime në natyrë, si strehim, mundësisht vakte ushqimi dhënë personave të moshuar ose në institucione të specializuara, ose duke qëndruar me familjet në lokale të përshtatshme, asistencë dhënë personave të moshuar për t'i ndihmuar në detyrat e përditshme , (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti

		<p>etj.), pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e moshuar, shërbime dhe përfitime të ndryshme dhënë personave të moshuar, për t'i bërë të aftë të marrin pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse ose për të udhëtuar apo për të marrë pjesë në jetën e komunitetit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Administrim, vënie në funksionim ose mbështetje për skema të tilla të mbrojtjes shoqërore
--	--	--

104: Familja dhe Fëmijët

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi ofron asistencë në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët dhe personat e marginalizuar.		
10430	Kujdesi shoqëror për familjet dhe fëmijët	<ul style="list-style-type: none"> • Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në vartësi • Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të njëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare • Përfitime në natyrë, si strehim dhe vakte ushqimi të dhëna për fëmijët parashkollorë gjatë ditës ose një pjesë të ditës • Ndihmë financiare assistance për pagesën e një kujdestareje që kujdeset për fëmijët gjatë ditës • Strehë dhe ushqim dhënë fëmijëve dhe familjeve në mënyrë të përhershme (jetimore, familje kujdestare etj.) • Mallra dhe shërbime dhënë në shtëpi fëmijëve ose atyre që kujdesen për ta • Shërbime dhe mallrat e ndryshme dhënë familjeve, të rinjve ose fëmijëve (qendra pushimi ose zbavitjeje) • Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore
10460	Përfshirje shoqërore	<ul style="list-style-type: none"> • Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigjenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktimat e dhunës kriminale etj.) • Përfitime në para, si kompensim page dhe pagesa të tjera për personat e varfër ose të dobët, për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë ose në situatë të vështira

		<ul style="list-style-type: none"> • Përfitime në natyrë, si strehë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe vakte ushqimi dhënë personave të varfër dhe të dobët, rehabilitim të abuzuesve me alkoolin dhe substancave të tjera, shërbime dhe mallra për të ndihmuar personat, si këshillim, strehim ditor, ndihmë për të kryer punët e përditshme, ushqim, veshje, lëndë djegëse etj. • Administrim dhe organizim të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore
--	--	--

105: Papunësia

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi ofron përfitime në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar; gjithashtu ai merr masa për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta, të rrezikuara.		
10550	Papunësi, edukim dhe trajnim profesional	<ul style="list-style-type: none"> • Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë të aftë për punë, të disponueshëm për punë, por janë të paaftë të gjejnë punësim të përshtatshëm • Pagesa për grupe të shënjestruara në forcën e punës që marrin pjesë në skemat e trajnimit që kanë për qëllim të zhvillojnë potencialin e tyre për punësim, kompensime për humbje të punës, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të papunët, në veçanti për të papunët afatgjatë. • Përfitime në natyrë, si pagesat për lëvizje dhe zhvendosje. • Trajnim profesional për personat pa punë ose ritrajnim për personat që rrezikojnë të humbin vendin e punës • Akomodim, ushqim ose veshje dhënë personave të papunë dhe familjeve të tyre • Administrim dhe organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore

106: Strehimi

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi jep mbrojtje shoqërore për të lehtësuar strehimin e përshtatshëm për njerëzit në nevojë.		
10661	Strehim shoqëror	<ul style="list-style-type: none"> • Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit • Administrim dhe organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore • Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë • Pagesa për të lehtësuar kostot aktuale të strehimit për pronarët-banorë (domethënë për të ndihmuar për të paguar kredinë ose interesat) • Dhënie strehimi me kosto të ulët ose shoqëror

107: Kujdesi Social

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Kontribut monetary si një mbështetje ekonomike dhe shërbime shoqërore për familjet dhe individët që nuk mund të arrijnë të ardhura minimale		
10770	Asistencë shoqërore (Ndihmë ekonomike)	<ul style="list-style-type: none">• Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjesh dhe individësh në nevojë

